Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Municipality Drenas
Kuvendi i Komunës

02 Nr.060/03-43886 dt. 16/10/ **2026**

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42, neni 44 pika 44.4 dhe pika 44.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit së Drenasit, kryesuesi i Kuvendit të Komunës:

Th ë rr e t

mbledhjen e **nëntë** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **datë: 26.10.2026** e cila do të fillojë në orën **10:00.**
Mbledhja do të mbahet në sallën e bordit të drejtorive, (kati tretë) i Komunës Drenasit.

Për mbledhje propozohet ky:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes se Komitetit për Politike dhe Financa i datës: 16.09.2026;
2. Propozim vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Gllogocit;
3. Propozim vendim për miratimin e Raportit mbi punën dhe aktivitetin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit Nr.02-052/01-43152 të datës 12.10.2026;
4. Propozim vendim për diskutim të Raportit të auditimit të pajtueshmërisë "menaxhimi i pronave të dhëna me qira në Komunën e Gllogocit për periudhën 2024-2025;
5. Propozim vendim për themelimin e organit të kujdestarisë në kuadër të Qendrës për punë sociale;
6. Deklaratë mbështetëse për parandalimin dhe eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj gravc në politikë dhe në jetën publike;
7. Raporti Financiar Janar-Shtator 2026;
8. Të ndryshme

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Burim Bujupi

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 060/04-42778 dt. 08/10/ 2026

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 16.09.2026, e cila filloi në orën 08:00.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KPF-së: Burim Bujupi (kryesues i Kuvendit), Fitore Morina-Hoxha (PDK-RLL), Selman Çallapeku (PDK-RLL), Pajtime Berisha (PDK), Arigon Sinani (PDK), Egzona Tërdevci (VV) dhe Arbër Halilaj (BD).

Të pranishëm ishin edhe: Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, si dhe Drejtori i Financave, Petrit Sinani.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Burim Bujupi,** kryesues i Kuvendit.

RENDI I DITËS:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politike dhe Financa i datës 18.08.2026;
2. Propozim - Buxheti i Komunës për vitin 2027 dhe projeksionet për vitet 2028-2029;
3. Pyetje dhe përgjigje;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, pasi përshëndeti të pranishmit dhe kërkoi që të shtohet edhe një pikë, me lejen e anëtarëve hapi diskutimin për ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës me dy pika shtesë.

1. Raporti i progresit për zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2025.
2. Propozim-vendim për plotësim-ndryshimin e pikës I të vendimit 02 Nr.020/04-11325 të datës 30.03.2026 për formimin e komisionit komunal të aksionarëve të NPL "Eko-Drenasi" SH.A.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hodhi në votim këtë rend dite. Të pranishëm ishin 6 anëtarë. Ky rend dite rekomandohet për Kuvend. Për votuan 7, abstenime 0, kundër 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e parë. **Pika (1)** Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur me18.08.2026. Meqenëse diskutime nuk pati, pika e parë e rendit të ditës kaloi. Për votuan 7, abstenime 0, kundër 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e dytë. **Pika (2)** Propozim-Buxheti i Komunës për vitin 2027 dhe projeksionet për vitet 2028–2029.

Egzona Tërdevci, tha se edhe kur është diskutuar korniza afatmesme buxhetore është vërejtur bashkimi i shumë projekteve në një kod dhe fakti që nuk po dimë se ku po janë të destinuara ato mjete. E kuptoj që prokurimi dhe sistemi i PIP-it nuk e lejojnë me i shkruajtur projektet gjatë, por a kishim mundur para seancës ne, si asamblistë, me pas një raport ku keni me i orientuar këto investime, nëse është Tërstenik apo Gllobar, ne me ditë cilat rrugë kanë me u asfaltuar.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e dytë. Propozim-Buxheti i Komunës për vitin 2027 dhe projeksionet për vitet 2028–2029. Për votuan 7, abstenime 0, kundër 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e tretë.**Pika (3)** Raporti i progresit për zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2025. Diskutime nuk pati dhe e hodhi në votim pikën e tretë që të rekomandohet për Kuvend. Për votuan 7, abstenime 0, kundër 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e katërt. **Pika (4)** Propozim-vendim për plotësim-ndryshimin e pikës I të vendimit 02 Nr.020/04-11325 të datës 30.03.2026 për formimin e komisionit komunal të aksionarëve të NPL "Eko-Drenasi" Sh.a. Meqenëse nuk pati diskutime, edhe kjo pikë u rekomandua për Kuvend. Për votuan 7, abstenime 0, kundër 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e pestë. **Pika (5)** Pyetje dhe përgjigje. Pasi nuk pati pyetje, kryesuesi tha: "Vazhdojmë me pikën e gjashtë: 6. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, pasi nuk pati diskutime të tjera, e konsideroi të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 8:25.

Kryesuesi i Kuvendit

Burim Bujupi

Procesmbajtësja: Fakete Hoti

Lekturoi: Nikelinda Bujupi

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Drenasit/Gllogocit
Opština Drenas/Gllgovac
Municipality of Drenas/Gllogoc

Zyra e Kryetarit

Nr.01/ 110/04 - 43703 **, dt.** 15 / 10 **/2026**

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, nenit 72 të Statutit te Komunës së Drenasit nr.01-110-6904 i dt.24.09.2008, vendimit nr.02-020/04-37193 të dt.31/08/2026, Kryctari i Komunës së Drenasit, propozon: që Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të dt. _____ /2026, të aprovojë këtë:

PROPOZIM PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E STATUTIT TË KOMUNËS SË GLLOGOCIT

Neni 1

Duke u bazuar në nenin 8 të Statutit të Komunës, për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës, bëhet plotësim-ndryshimi i këtij Statuti, si dhe shtohen dy drejtori të reja: Drejtoria për Prokurim dhe Drejtoria për Pronë; gjithashtu bëhen riformulime në emërtim dhe modifikim të detyrave dhe përgjegjësive të tri drejtorive ekzistuese: *Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë tani emërtohet si Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme dhe Drejtoria për Infrastrukturë Lokale tani emërtohet si Drejtoria për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave.*

Neni 2

Neni 3, paragrafi 3.2 i Statutit të Komunës plotësohet dhe ndryshohet si në vijim: Selia e Komunës së Gllogocit (në tekstin e mëtejmë: "Komuna") është në Gllogoc, në rrugën "Fehmi dhe Xhevë Lladrovci" nr. 2.

Neni 3

Neni 3 i ndryshimit dhe plotësimit të Statutit të Komunës nr. 12-030-19523, i datës 06/04/2018, ndryshohet si në vijim: **Drejtoria për Infrastrukturë Lokale tani emërtohet si Drejtoria për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave dhe i ka këto detyra dhe përgjegjësi:**

1.Harton programin zhvillimor afatgjatë dhe afatmesëm të investimeve kapitale dhe menaxhimit të kontratave në nivel të komunës, në përputhje dhe në bashkëpunim me bashkësitë lokale dhe në harmoni me zhvillimin urbanistik të vendbanimeve dhe viseve rurale;
2. Është përgjegjëse për planifikimin dhe menaxhimin e të gjitha investimeve kapitale dhe menaxhimin e kontratave në Komunën e Drenasit;
3. Përpilon paramasa dhe parallogari lidhur me investimet kapitale;

4. Zbatimin dhe monitorimin e projekteve kapitale varësisht nga kërkesat e drejtorive komunale;
5. Sigurimin e cilësisë gjatë fazave të ndërtimit përmes monitorimit dhe kontrollit teknik;
6. Planifikimin dhe organizimi i mirëmbajtjes së rrjetit rrugor, trotuareve, shtigjeve të biçikletave, urave dhe elementeve të tjera të rrugës duke përfshirë sanimin e sipërfaqes qarkulluese të rrugës, deformimet boshtore dhe dëmtimet e tjera strukturore të rrugëve;
7.Hartimi i detyrave projektuese, monitorimi i cilësisë së punimeve dhe materialeve ndërtimore;
8. Është përgjegjëse për menaxhimin (mbikëqyrjen) e kontratave për investime kapitale: të ndërtimit, rindërtimit dhe sanimit të objekteve të administratës, shëndetësisë, arsimit dhe infrastrukturës rrugore (kanalizimet fekale, atmosferike, kabllore, ujësjellësin, asfaltimin, ndriçimin publik, sinjalizimin horizontal dhe vertikal) në qytet dhe vise rurale;
9. Përcjell dhe studion rrjedhat e zhvillimit të infrastrukturës së komunës dhe cakton kriteret e ndërtimit të infrastrukturës rrugore; Përgatit detyrat projektuese dhe bën kategorizimin e objekteve të infrastrukturës lokale dhe rurale;
10. Harton projektet e vogla të infrastrukturës, sipas kërkesave të bashkësive lokale; Lëshon leje për ndërtim (të infrastrukturës rrugore) dhe leje për gropim dhe hapje të kanaleve, të cilat i bëjnë ndërmarrjet publike si dhe leje për kyçje individuale të qytetarëve në rrjetin e infrastrukturës;
11. Cakton organin mbikëqyrës për mbikëqyrjen dhe komisionin për kontrollim teknik të objekteve të ndërtuara, në bashkëpunim me Drejtorinë e Prokurimit;
12. Hartimin e raporteve periodike në lidhje me investimet kapitale dhe menaxhimin të kontratave dhe hartimin e rekomandimeve për përmirësime të infrastrukturës në bazë të vlerësimeve teknike;
13. Arkivon dokumentacionin teknik të investimeve kapitale dhe menaxhimit të kontratave;
14. Kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushëpërkatësisë së veprimtarisë së Drejtorisë.

Neni 4

Neni 9, nënparagrafi 9.1 i të Statutit të Komunës plotësohet ndryshohet si në vijim:
Territori i Komunës së Gllogocit është përcaktuar në Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave dhe Komuna e Gllogocit është e përbërë prej këtyre vendbanimeve:

1. Abri e Epërme
2. Arllat
3. Baicë
4. Çikatovë e Re
5. Çikatovë e Vjetër
6. Domanek
7. Dobroshec
8. Fushticë e Epërme
9. Fushticë e Poshtme
10. Gllogoc
11. Gllobar
12. Gllanasellë
13. Godanc
14. Gradicë
15. Kishnarekë
16. Komoran
17. Korroticë e Epërme

18. Korroticë e Poshtme
19. Krajkovë
20. Likoshan,
21. Llapushnik,
22. Negroc
23. Nekoc
24. Poklek
25. Polluzhë
26. Sankoc
27. Shtrubullovë
28. Shtuticë
29. Tërdec
30. Tërstenik
31. Vasilevë
32. Vërboc
33. Vuçak
34. Zabel i Epërm
35. Zabel i Ulët

Neni 5

Nenit 9, nënparagrafi 9.2 i të Statutit të Komunës plotësohet ndryshohet si në vijim:
Lagjet urbane janë:
Qendra 1
Qendra 2
Qendra 3
Drenasi 1
Drenasi 2
Drenasi 3
Komoran Zona Qendër

Neni 6

Neni 9 i Statutit të Komunës plotësohet dhe ndryshohet si në vijim: Organet komunale obligohen që t'i informojnë qytetarët me shkrim lidhur me kërkesat e tyre, si dhe t'ju lejojnë qasje në dokumentet zyrtare në pajtim me ligjin përkatës dhe aktet nënligjore.

Neni 7

Neni 29 i Statutit të Komunës ndryshohet emërtimi dhe përmbajtja si në vijim: emërtimi nga *qasja në dokumente zyrtare* në *qasje në dokumente publike* si dhe përmbajtja: qasja në dokumente publike është e rregulluar me ligjet përkatëse dhe aktet e tjera nënligjore.

Neni 8

Neni 34, paragrafi 34.3 i Statutit të Komunës plotësohet dhe ndryshohet si në vijim: Kuvendi i Komunës i ka 27 anëtarë, miraton Statutin dhe e ndryshon atë, nëse konsideron se një gjë e tillë është e nevojshme. Statuti i komunës miratohet dhe mund të ndryshohet me, së paku, votimin e dy të tretave të anëtarëve të kuvendit të komunës, ndërsa rregullorja e punës miratohet dhe ndryshohet, kur të jetë e nevojshme, me votimin e shumicës së anëtarëve të kuvendit të komunës.

Neni 9

Neni 37, paragrafi 37.2 i Statutit të Komunës - plotësohet dhe ndryshohet si në vijim: Kuorumi për të gjitha takimet e kuvendit të komunës dhe komiteteve të tij është së paku gjysma e numrit të anëtarëve të kuvendeve komunale. Kuorumi duhet të verifikohet para çdo vendimi të marrë.

Neni 10

Neni 37 i Statutit të Komunës - plotësohet dhe ndryshohet si në vijim: Kuvendet komunale themelojnë Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete si komitete të përhershme.

Neni 11

Te neni 76 i Statutit të Komunës, te drejtoritë komunale, nënparagrafi 76.1, i shtohen: pika ll – Drejtoria e Prokurimit dhe pika m – Drejtoria për Pronë; kurse pika g) ndryshohet si në vijim: Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër; dhe pika h) ndryshohet si në vijim: Drejtoria për Inspekcion. Nënparagrafi 76.2, pika f) ndryshohet si në vijim: Drejtori i Drejtorisë për Inspekcion; dhe pika j) ndryshohet si në vijim: Drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 12

DREJTORIA PËR PROKURIM

Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Prokurim janë:

1. E bën parakualifikimin e furnizuesve, përgatitjen e dokumenteve të ofertimit (fletës për oferta, kërkesave për kuotime dhe kërkesave për propozime) dhe lëshimin e tyre, administrimin e tenderëve, monitorimin e procesit të prokurimit, përgatitjen e hapjes publike të ofertave dhe përpilimin e raporteve;
2. Është përgjegjëse për klasifikimin e dokumenteve përkatëse dhe bën mirëmbajtjen e librarisë teknike;
3. E mirëmban listën e azhurnuar të kontraktuesve dhe furnizuesve. Kjo informatë mund të mbahet lokalisht, ose nga bazat e të dhënave prej AQF-së dhe Njësisë Qendrore të Prokurimit në Ministrinë e Shërbimeve Publike;
4. Përmes AQF-së siguron që të gjithë furnizuesit, apo agjentët e emëruar të Kosovës janë të regjistruar dhe janë njësi tatimpaguese; në të kundërtën, ata nuk mund të konsiderohen për pjesëmarrje në ndonjë ofertim ose procedurë të kuotimit;
5. Siguron që mallrat dhe shërbimet të prokurohen në mënyrë sa më ekonomike, efikase dhe efektive;
6. Të përgatisë specifikime të hapura, të sigurojë trajtim të barabartë dhe konkurrencë ndërmjet gjithë furnizuesve;
7. Organizon procedurën e kuotimit dhe të tenderit varësisht nga çmimi i vlerësuar në bazë të limiteve financiare të miratuara;
8. Asiston në aranzhimin e procedurave dhe krijimin e komisioneve për vlerësim;
9. Me mbarimin e procesit të vlerësimit dhe procesit administrativ, e përgatit kontratën dhe lëshon urdhrin për blerje;
10. Menaxhon ofrimin e produkteve dhe shërbimeve në fushën e prokurimit;
11. Zhvillon dhe propozon politika në lidhje me prokurimin publik dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
12. Koordinon me KRPP, APP, OSHP rreth çështjeve të shfaqura të prokurimit;
13. Koordinon punën me menaxherët tjerë në institucion;

14. Asiston në monitorimin dhe ekzekutimin e kontratave dhe urdhrave për blerje;
15. Përcjellë shpërndarjen e mallrave dhe shërbimeve në bazë të marrëveshjes;
16. E bën kontrollimin e faturës në pajtim me kontratën me shënimet mbi mallrat e pranuara, shënimet e dërgesës të nënshkruara nga nëpunësi i emëruar për pranimin e mallrave;
17. Kryen edhe detyra të tjera që kanë të bëjnë me prokurimin.

Neni 13

Neni 81 i Statutit të Komunës përmirësohet emërtimi si në vijim: nga *Drejtorati për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit* në **Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.**

Neni 14

DREJTORIA PËR PRONË

Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Pronë janë:

1. Menaxhon me pronën në pronësi komunale;
2. Mban shënime për tokën dhe objektet në pronësi të Komunës;
3. Zhvillon procedurën e shpronësimit të tokës në pronësi private dhe shoqërore për ngastrat e planifikuara për interes publik sipas planeve urbanistike të Komunës;
4. Përgatit vendimet e shpronësimit për personat fizikë dhe juridikë;
5. Arrin marrëveshje dhe nënshkruan kontrata me anë të së cilave siguron tokën e nevojshme për realizimin e interesit publik;
6. Nxjerr vendime për regjistrimin e të drejtës së pronësisë në emër të Komunës, në paluajtshmëritë e mbetura pa pronar;
7. Trajton dhe zhvillon procedurën administrative për uzurpimet arbitrare të tokës në pronësi të Komunës;
8. Nxjerr vendimet për lirimin e pronës komunale të uzurpuar arbitrarisht;
9. Shqyrton dhe vendos për kërkesat e personave fizikë dhe juridikë në procedurë administrative, për rregullimin e marrëdhënieve pronësore-juridike lidhur me pronën komunale;
10. Zhvillon procedurat administrative, sipas detyrës zyrtare, për ruajtjen e pronës komunale dhe interesit tjetër komunal;
11. Bën identifikimin dhe matjet gjeodezike në bazë të kërkesës së drejtorive për realizimin e projekteve komunale;
12. Përpunon konkluzionet pas plotfuqishmërisë së vendimit në procedurë administrative dhe pronësore-juridike;
13. Përgatit inicimin e procedurës për kallëzim penal, së bashku me përfaqësuesin juridik të Komunës, lidhur me uzurpimet arbitrare të pronës komunale;
14. Harton materialin e nevojshëm për Këshillin e Drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa dhe për Kuvendin e Komunës;
15. Përcjell vendimet që kanë të bëjnë me shpronësimet për publikim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;
16. Thërret dhe njofton palët e interesit për nxjerrjen e vendimit të shpronësimit;
17. Bashkëpunon ngushtë me drejtorinë e linjës për të dhënat gjeodezike dhe ato pronësore;
18. Koordinon punën me drejtorinë kompetente për punët e ndërtimit dhe të kadastrit, në aspektin e lejeve të ndërtimit dhe të dhënave kadastrale;
19. Kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme, në kuadër të fushëveprimtarisë së Drejtorisë.

Neni 15

Neni 77 i Statutit të Komunës plotësohet dhe ndryshohet si në vijim:

1. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, në kuadër të fushëveprimtarisë së saj, ushtron dhe është përgjegjëse për:
2. Ushtrimin dhe zbatimin e shërbimeve të përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera komunale dhe ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët e Komunës së Gllogocit, në kuadër të kompetencave vetanake apo të delegjuara ligjore të saj. Shërbimet e përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera komunale të Drejtorisë së Administratës përfshijnë:
3. Ofrimin e shërbimeve dhe kryerjen e punëve administrative mbështetëse për punët e Kuvendit të Komunës, të Bordit të Drejtorëve dhe të trupave punues (komiteteve) të Kuvendit Komunal;
4. Bën propozimet (hartimet) e projektregulloreve dhe propozimvendimeve të përgjithshme administrative, si dhe ushtron propozime për ndryshimin dhe plotësimin e akteve të përgjithshme nënligjore në fuqi (në juridiksionin komunal);
5. Zbaton dhe bën regjistrimin dhe mbajtjen e evidencës së materialit zyrtar që pranohet dhe dorëzohet nga zyra e arkivit të administratës së Komunës, si dhe arkivimin e lëndës arkivore dhe kujdesin për ruajtjen e saj, dhe kujdesin për ruajtjen e akteve materiale të administratës (librat amë, kartotekat, protokollet, regjistrat etj.);
6. Ofron të gjitha format e shërbimeve dhe të ndihmës juridike për qytetarët, përfshirë regjistrimin e të gjitha kërkesave dhe parashtresave të tyre, dhe bën raportimin për kryerjen e lëndëve administrative në përputhje me afatet ligjore;
7. Është përgjegjëse dhe kujdeset për ofrimin e shërbimeve postare për nevojat e organeve komunale dhe organeve të administratës komunale;
8. Ushtron dhe menaxhon me fushën e logjistikës, duke përfshirë menaxhimin dhe kujdesin për automjetet, titullar pronësor i të cilave është Komuna e Gllogocit;
9. Organizon dhe kujdeset për mirëmbajtjen e objekteve të administratës komunale, duke përfshirë organizimin e shërbimeve të sigurimit për këto objekte;
10. Ushtron të gjitha punët rreth përkujdesjes dhe mirëmbajtjes së teknologjisë informative dhe avancimit të saj për nevoja zyrtare;
11. Kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme, në kuadër të fushëveprimtarisë së Drejtorisë.

Neni 16

Neni 83 i Statutit të Komunës: Drejtoria e Inspektimit Komunal riformulohet me emërtimin „Drejtoria për Inspekcion" dhe modifikohen detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj Drejtorie.

Drejtoria për Inspekcion i ka këto detyra dhe përgjegjësi:

1. Mbikëqyrjen inspektuese me qëllim të mbrojtjes së rrugëve publike komunale, pronës së paluajtshme, aseteve, instalimeve publike komunale, trotuareve, shesheve, parqeve, varrezave, shtitoreve, sipërfaqeve të gjelbëruara dhe sipërfaqeve/hapësirave të tjera publike komunale, nga uzurpimet, dëmtimet, keqpërdorimet dhe shfrytëzimet pa pëlqime/autorizime, kontrata përkatëse, si dhe mbikëqyrjen inspektuese në fushën e transportit dhe komunikacionit;
2. Verifikimin e dokumenteve, pëlqimeve apo autorizimeve, kontratave përkatëse të cilat shfrytëzuesit e sipërfaqes/hapësirave publike, pronës, aseteve komunale duhet t'i posedojnë;

3. Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave ligjore dhe akteve të tjera nënligjore lidhur me detyrimet dhe përgjegjësitë e pronarëve të njësive të ndërtesës së banimit në bashkëpronësi në lidhje me pamjen e jashtme të ndërtesave, shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve, hapësirave dhe pajisjeve të përbashkëta të ndërtesës;
4. Mbikëqyrjen inspektuese të transportit të rregullt të udhëtarëve, transportit të lirë të udhëtarëve, transportit taksi të udhëtarëve dhe transportit të udhëtarëve për nevoja vetanake;
5. Mbikëqyrjen inspektuese të aktiviteteve që kanë ndikim në mjedis dhe kontrollimin e zbatimit të standardeve për mbrojtjen e mjedisit përmes inspektimit mjedisor në zbatimin e ligjeve përkatëse dhe akteve nënligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
6. Ekzekutimin e vendimeve dhe urdhëresave të Zyrtarit Kryesor Administrativ të Komunës nga fushëveprimi i inspektorëve të shërbimeve publike, transportit/komunikacionit dhe mbrojtjes së mjedisit;
7. Mbikëqyrjen inspektuese të përputhjes së ndërtimit me dokumentacionin ndërtimor dhe kodin e aplikuar ndërtimor;
8. Mbikëqyrjen inspektuese të instalimeve, renovimit dhe zgjerimit të ndërtesave sipas dokumentacionit përkatës;
9. Mbikëqyrjen inspektuese të ndërrimit të destinimit dhe rrënimin e çfarëdo ndërtese apo strukture pa leje përkatëse;
10. Nxjerrjen e akteve administrative për mënjanimin e parregullsive, për mbylljen e vendndërtimit, për ndalimin e punimeve e deri në rrënim të objekteve;
11. Mbikëqyrjen inspektuese të çdo objekti ndërtimor brenda kompetencave të inspektoratit të ndërtimit në komunë;
12. Punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore të nxjerra nga Qeveria, ministritë e linjës dhe Kuvendi i Komunës së Gllogocit.

Neni 17

Neni 84 i Statutit të Komunës: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë riformulohet me emërtimin „Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër" dhe modifikohen detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj Drejtorie.

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër i ka këto detyra dhe përgjegjësi:

1. Është përgjegjëse për zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve gjeodezike dhe kadastrale, rrjetin referues homogjen, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ për tokën dhe pronën;
2. Ofron shërbime profesionale dhe shërbime të tjera për subjekte të interesuara;
3. Planifikon rrjetin me pika të reja kontrolluese dhe themelon pika të reja kontrolluese;
4. Digjitalizon pikat poligonale dhe trigonometrike, vektorizimin e planeve të skanuara (ngastrave dhe zonave kadastrale);
5. Azhurnon pjesën grafike në bazë të dokumenteve dhe matjeve të reja dhe i transformon me parametrat e dhëna për transformim;
6. Ofron shërbime rreth mirëmbajtjes dhe klasifikimit të kulturave të tokës;
7. Ofron shërbime për ndarjen e ngastrave dhe shënimin e kufijve në rastet e shpronësimeve;

8. Kryen punë profesionale në fushën e gjeodezisë (ndryshimet e bëra gjatë matjeve-bartjes së tyre në programin e gjeodezisë);
9. Ofron shërbime për shënimet e digjitalizuara (dhënien e koordinatave në terren);
10. Kontrollon rrjetet dhe matjet gjeodezike;
11. Incizon sipërfaqet e ndërtesave dhe pjesëve të tyre, objektet nëntokësore dhe mbitokësore dhe i përpunon skicat;
12. Regjistron pronën e paluajtshme dhe tokën komunale;
13. Zhvillon procedurën e regjistrimit, në përputhje me ligjet, sipas detyrës zyrtare dhe kërkesave të palëve;
14. Korrigjon regjistrin (RDPP) sipas procedurave dhe dispozitave ligjore në fuqi;
15. Azhurnon regjistrin e pronave në bazë të dokumenteve të verifikuara dhe shënimeve të tjera nga dokumentacioni arkivor, si dhe regjistrit të ndërrimeve të mjeteve nga terreni;
16. Zbaton procedurat rreth transaksioneve të pronës publike në RDPP;
17. Shqyrton dhe zhvillon procedurat administrative për rikthimin e paluajtshmërisë ish-pronarit, evidenton dhe shlyen masat e përkohshme sipas aktvendimit të gjykatës kompetente;
18. Udhëheq me kadastrën etazhore të banesave, ndërtesave, si dhe ngastrat kadastrale në të cilat janë të ndërtuara banesat;
19. Regjistron dhe çregjistron hipotekat;
20. Merr vendime mbi regjistrimin e servituteve, barrën tatimore, ngastrat e tatimit në pronë dhe shënimet lidhur me dorëzanitë;
21. Lëshon certifikata për patundshmëri, sipas kërkesave;
22. Mirëmban, korrigjon dhe harmonizon evidencat e vendbanimeve, fshatrave, shesheve, rrugëve dhe numrat e objekteve dhe ndërtesave;
23. Nxjerr vendime për miratim ose refuzim të kërkesave;
24. Nxjerr konkluzione për plotësimin e kërkesave të pakompletuara;
25. Kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme, në kuadër të fushëveprimtarisë së Drejtorisë.

Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit

Nr 01-052/01-43253 **dt.** 13/10/**2026**

Në bazë të nenit 58 i Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit te Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 11, 12, 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës''), Vendimit 02 Nr.020/04-7735 të datës 27.02.2026 të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Komunën e Drenasit, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e ardhshme të aprovoi këtë:

P r o p o z i m V e n d i m

Për miratimin e Raportit mbi punën dhe Aktivitetin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit Nr.02-052/01-43152 të datës 12.10.2026

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës që të miratoj Raportin mbi punën dhe Aktivitetin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit Nr.02-052/01-43152 të datës 12.10.2026

Neni 2

Qëllimi i këtij raporti është miratimi i kërkesave dhe ankesave të shqyrtuara e të cilat janë parashtruar nga qytetarët lidhur me emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në territorin e Komunës së Drenasit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, udhëzimet administrative dhe kriteret e përcaktuara nga institucionet kompetente.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi janë përgjegjëse Kuvendi Komunal, Zyra e Kryetarit si dhe drejtoritë tjera kompetente.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Komuna e Drenasit me datë 12.10.2026 nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit ka pranuar Raportin mbi punën dhe aktivitetin e këtij komisioni, me Nr.02-052/01-43152 të datës 12.10.2026, ku duke marrë parasysh këtë dhe nevojës së shqyrtimit të të njëjtit, Kryetari i Komunës përmes këtij propozim vendimi i propozon Kuvendit të Komunës që duke marr parasysh legjislacionin në fuqi dhe nevojës për diskutimin dhe trajtimin me prioritet të raportit në fjalë që synon adresimin dhe zgjedhjen e problemeve të kësaj natyre në nivel lokal të votohet ky propozim vendim.

Republika e Kosovës
Komuna e Drenas(Gllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr.052/01-43152 dt. 12/10/2026

RAPORT

I KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit

Drejtuar:	**Kuvendit të Komunës së Drenasit / Zyrës së Kuvendit të Komunës së Drenasit**
Nga:	**Xhavit Drenori:** _____ **Kryesuesi i Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit**
Lënda:	**Raport mbi punën dhe aktivitetin e Komisionit**
Periudha e punës:	**16.04.2026 – 02.10.2026**
Data:	**08.10.2026**

I. BAZA LIGJORE DHE THEMELIMI I KOMISIONIT

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit është themeluar me Vendim të Kuvendit të Komunës së Drenasit, të miratuar në mbledhjen e mbajtur më 26.02.2026.

Numri i vendimit: 02 Nr. 020/04-7735
Data: 27.02.2026

Komisioni është themeluar me qëllim të shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve lidhur me emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në territorin e Komunës së Drenasit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, udhëzimet administrative dhe kriteret e përcaktuara nga institucionet kompetente.

Përbërja e Komisionit

Komisioni kishte këtë përbërje:

1. Ekrem Elshani – Anëtar;

2. Qendresë Xhema – Anëtare;
3. Artian Krasniqi – Anëtar;
4. Luljeta Elshani – Anëtare;
5. Xhavit Drenori – Anëtar.

II. MBLEDHJA E PARË DHE FILLIMI I PUNËS SË KOMISIONIT

Mbledhja e parë inauguruese e Komisionit është mbajtur më 16.04.2026, pas përfundimit të procedurave përkatëse lidhur me ligjshmërinë e vendimit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

Mbledhjen e parë e hapi znj. Liridona Fejza Ajazi, nga Zyra e Kuvendit të Komunës së Drenasit, e cila i njoftoi anëtarët e Komisionit në mënyrë të përgjithshme lidhur me mandatin, përgjegjësitë dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit, si dhe me natyrën e kërkesave dhe ankesave që do të shqyrtoheshin.

Në këtë takim, anëtarëve të Komisionit iu shpërndanë dokumentacioni dhe materialet relevante nga komisionet e mëparshme, si dhe dokumentet dhe aktet ligjore të institucioneve përkatëse shtetërore që rregullojnë fushën e emërtimit të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike.

Gjatë kësaj mbledhjeje, zyrtari komunal për Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS), z. Besart Bajrami, rekomandoi që, para fillimit të shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave, të zhvillohej një takim me zyrtarët e Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), me qëllim të sqarimit të çështjeve juridike dhe teknike, si dhe të harmonizimit të punës së Komisionit me sistemin e adresave.

Ky rekomandim u miratua unanimisht nga anëtarët e Komisionit.

Në këtë mbledhje u votua Xhavit Drenori për kryesues të komisionit, me arsyetimin e pervojës në një komision të tillë gjatë legjislaturës 2013-2017.

III. TAKIMI ME ZYRTARËT E AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS

Më 24.04.2026, në Komunën e Drenasit u organizua takim pune me zyrtarët e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, me qëllim të qartësimit të procedurave, kritereve dhe bazës ligjore që duhej të ndiqej gjatë shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike.

Në këtë takim, Komisioni u informua dhe mori udhëzimet përkatëse lidhur me mënyrën e veprimit dhe kriteret që duhej të zbatoheshin gjatë shqyrtimit të secilës kërkesë dhe ankesë.

Ndër të tjera, nga zyrtarët e Agjencisë Kadastrale të Kosovës u sqarua se, sipas udhëzimeve administrative dhe procedurave në fuqi, nuk mund të bëhen ndryshime në emërtimet ekzistuese të rrugëve deri në vitin 2029, me qëllim të përshpejtimit dhe përfundimit të procesit të adresimit në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Megjithatë, u sqarua se mund të merren parasysh raste të veçanta, veçanërisht kur nga një rrugë kryesore ka devijime apo rrugica të cilat, për shkak të nevojave të sistemit të adresave

dhe lehtësimit të gjetjes së adresave nga shërbimet emergjente, mund të kërkojnë trajtim të veçantë.

Gjithashtu, për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave të reja u prezantuan kriteret përkatëse, ndër të cilat u theksua se, në parim, një segment i ri duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara, përfshirë minimumin prej 10 shtëpive dhe gjatësinë minimale prej 100 metrash.

Në të njëjtën kohë, u sqarua se edhe për këto kritere mund të ketë përjashtime, kur një gjë e tillë arsyetohet nga nevoja për funksionalizimin e sistemit të adresave dhe, në veçanti, për lehtësimin e gjetjes së adresave nga shërbimet emergjente dhe institucionet tjera kompetente.
Pas këtij takimi, Komisioni vazhdoi punën duke u bazuar në udhëzimet, kriteret dhe sqarimet e dhëna nga institucionet kompetente.

IV. ECURIA E PUNËS DHE SHQYRTIMI I KËRKESAVE DHE ANKESAVE

Nga data 27.04.2026 deri më 02.10.2026, Komisioni ka zhvilluar gjithsej 23 mbledhje pune.

Gjatë kësaj periudhe, Komisioni ka shqyrtuar gjithsej 571 kërkesa dhe ankesa të paraqitura nga qytetarët e Komunës së Drenasit, të cilat datojnë nga viti 2017 dhe janë shqyrtuar deri në përfundimin e punës së Komisionit më 02.10.2026.

Nga gjithsej 571 kërkesa dhe ankesa të shqyrtuara, 262 kërkesa janë aprovuar nga Komisioni, në pajtim me kriteret dhe kushtet e përcaktuara nga legjislacioni dhe udhëzimet përkatëse.

Për secilën mbledhje të Komisionit është hartuar procesverbal, i cili përmban çështjet e trajtuara, diskutimet e zhvilluara, shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave, si dhe vendimmarrjen përkatëse të Komisionit.

Procesverbalet e mbledhjeve janë hartuar nga Kryesuesi i Komisionit dhe i bashkëngjiten këtij raporti.

V. PËRFUNDIM

Komisioni, gjatë periudhës së ushtrimit të mandatit të tij, ka zhvilluar punën në mënyrë të vazhdueshme dhe në përputhje me detyrat e përcaktuara me vendimin e Kuvendit të Komunës së Drenasit, si dhe duke marrë për bazë udhëzimet dhe sqarimet e institucioneve kompetente.

Në kuadër të punës së tij, Komisioni ka shqyrtuar një numër të konsiderueshëm të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, duke trajtuar gjithsej **571** raste, prej të cilave **262** janë aprovuar.

Gjatë procesit të shqyrtimit, Komisioni është përpjekur që secilës kërkesë dhe ankesë t'i kushtojë vëmendjen e nevojshme dhe ta trajtojë atë në mënyrë të paanshme, transparente dhe në përputhje me kriteret ligjore dhe teknike të përcaktuara nga institucionet kompetente.

Me përfundimin e shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave më 02.10.2026, Komisioni e konsideron të përfunduar punën e tij në kuadër të mandatit të dhënë, për këtë faze të procesit.

Për këtë arsye, ky raport i dorëzohet Kuvendit të Komunës së Drenasit / Zyrës së Kuvendit të Komunës së Drenasit, së bashku me dokumentacionin përcjellës, procesverbalet e mbledhjeve dhe listën përkatëse të emërtimeve të rrugëve dhe rrugicave, për procedim të mëtejmë sipas kompetencave ligjore.

Drenas, 12.10.2026
Kryesuesi i Komisionit
Xhavit Drenori

Lista e Emrave Rezervë të ZQP-vë në komunën e Drenasit		
Numri Rendor	**Emri i ZQP-së**	**Tipi i ZQP-së**
1	BEKIM LUMI	Rrugë
2	MARTIRËT BRAHAJ	Rrugë
3	ZYMER HYSENAJ	Rrugë
4	ALI STRUMCAKU	Rrugë
5	SEFULLAH MULIQI	Rrugë
6	RIZAH BUJUPI	Rrugë
7	LULZIM GASHI	Rrugë
8	JAKUP ALIA	Rrugë
9	SHABAN ADEMI	Rrugë
10	E ÇARRAVE	Rrugë
11	LIMAN SALI BUJUPI	Rrugë
12	XHEMAJL BUJUPI	Rrugë
13	FADIL BUJUPI	Rrugë
14	MUSLI MORINA	Rrugë
15	KADRI TOPALLI	Rrugë
16	MUSA ELSHANI	Rrugë
17	DAN LEKU	Rrugë
18	HAXHI KIQINA	Rrugë
19	QERIM KIQINA	Rrugë
20	TAHIR BEQIRI	Rrugë
21	AHMET SHISHANI	Rrugë
22	ILAZ DERVISHI	Rrugë
23	RRAHMAN TOPILLA	Rrugë
24	KADA KRASNIQI	Rrugë
25	LATIF MEHANI	Rrugë
26	HASAN MALOKU	Rrugë
27	SHEFQET HISENAJ	Rrugë
28	ASLLAN FAZLI LLADROVCI	Rrugë

29	VESEL NIKA	Rrugë
30	SAHIT NIKA	Rrugë
31	GANI NIKA	Rrugë
32	HALIM BEQA	Rrugë
33	HETEM BINAKU	Rrugë
34	VËLLËZËRIT BINAKU	Rrugë
35	ARIF TAFË ELSHANI	Rrugë
36	ISLAM SHABAN MORINA	Rrugë
37	SEFER ELSHANI	Rrugë
38	MUSLI BINAKU	Rrugë
39	XHELADIN TËRDEVCI	Rrugë
40	ANITA MEHMETI	Rrugë
41	SHIQIR ISMAJLI	Rrugë
42	XHEVAT ALI BAHTIJARI	Rrugë
43	HISEN JANOVA	Rrugë
44	PATRIK ISUFI	Rrugë
45	REXHEP RAMA	Rrugë
46	ISLAM LIKA	Rrugë
47	ALI E SADRI GASHI	Rrugë
48	UKSHIN E HAMËZ DUBOVCI	Rrugë
49	BAJRAM LATIF MORINA	Rrugë
50	ZEQIR MEHANI	Rrugë
51	ISUF MORINA	Rrugë
52	BINAK DESKAJ	Rrugë
53	SADRI DELIJAJ	Rrugë
54	MBRETËRESHA TEUTË	Rrugë
55	SHABAN SHABANI	Rrugë
56	SEJDI GASHI	Rrugë
57	E RRUKIQËVE	Rrugë
58	AHMET BALIU	Rrugë
59	RASHIT DUGOLLI	Rrugë
60	SHAIP PLAKIQI	Rrugë
61	BAJRAM RAMA	Rrugë
62	LIRIDON KIQINA	Rrugë
63	ARTON ZEKA	Rrugë
64	VESEL GASHI	Rrugë
65	SADRI LATA	Rrugë
66	HALIL UKA	Rrugë
67	SINAN HALILAJ	Rrugë
68	XHEMË HALILAJ	Rrugë
69	SKENDER SHALA	Rrugë
70	HALIT REXHEPI	Rrugë
71	XHEVAT HAJDINI	Rrugë
72	YMER PRIZRENI	Rrugë
73	MUHARREM ELSHANI	Rrugë

74	GANI CURRI	Rrugë
75	ZENË LOSHI	Rrugë
76	XHEMSHIT BUÇINCA	Rrugë
77	JAHIR E HALIL CËRVADIKU	Rrugë
78	SAMILE MUQOLLI	Rrugë
79	UKË BYTYQI	Rrugë
80	TAHIR DANI	Rrugë
81	NEBIH ABDULLAHU	Rrugë
82	TAHIR REXHEPI	Rrugë
83	FAIK REXHEPI	Rrugë
84	QERIM J HAJDINI	Rrugë
85	HISEN HAJDINI	Rrugë
86	MEHMET HAJDINI	Rrugë
87	MUHARREM J HAJDINI	Rrugë
88	XHAVIT MALOKU	Rrugë
89	AHMET E MILAIM ISTOGU	Rrugë
90	MUHAMET SHALA	Rrugë
91	ARIAN A PROKSHI	Rrugë
92	ZYMER ZHUSHI	Rrugë
93	AVDYL IBUSH GLLAREVA	Rrugë
94	BRAHIM SYLA	Rrugë
95	RIZAH TIKU	Rrugë
96	AHMET DOBRA	Rrugë
97	HALIL E AVDYL GASHANI	Rrugë
98	5 VËLLËZËRIT BYLYKBASHI	Rrugë
99	SOKOL SPAHIU	Rrugë
100	BRAHIM TAFALECI	Rrugë
101	HASAN SYLA	Rrugë
102	AJET DVORANI	Rrugë
103	PIKA LAJTHIA	Rrugë
104	ILAZ S DVORANI	Rrugë
105	ZENEL BYLYKBASHI	Rrugë
106	FERAT GJOKA	Rrugë
107	SMAJL KLUNA	Rrugë
108	JETULLAH BASHOTA	Rrugë
109	VEHBI GRUDA	Rrugë
110	MUSË DANI	Rrugë
111	REXHEP BASHOTA	Rrugë
112	HALIL IBRAHIMI	Rrugë
113	LIMAN ISLAMI	Rrugë
114	RAGIP MULAKU	Rrugë
115	SALI MULAKU	Rrugë
116	HALIT ZOGAJ	Rrugë
117	IDRIZ S OBRIA	Rrugë
118	MUHARREM ALUSHANI	Rrugë

119	ZYMER NISHORI	Rrugë
120	BINAKU	Rrugë
121	BUJAR BASHOTA	Rrugë
122	SYLË IBRIQI	Rrugë
123	MARTIRËT MUQOLLI	Rrugë
124	RAMADAN B KRASNIQI	Rrugë
125	HYD RAMA	Rrugë
126	BAJRAM PODRIMQAKU	Rrugë
127	ZEQIR BRAHIM MALIQI	Rrugë
128	MUSLI HYSENAJ	Rrugë
129	MEXHID SAHITI	Rrugë
130	DELI RAMADANI	Rrugë
131	SYLË SEJDIU	Rrugë
132	IDRIZ R OBRIA	Rrugë
133	AVDULLAH DOBËRDOLANI	Rrugë
134	SADRI SINANI	Rrugë
135	HAJDAR RAMADANI	Rrugë
136	HAXHI BRAHIMI	Rrugë
137	SOKOL HAJRIZI	Rrugë
138	ASLLAN AVDULLI	Rrugë
139	HALIL BEKOLLI	Rrugë
140	MISIN IMERI	Rrugë
141	BLEART S DELIU	Rrugë
142	BAHTIR HASANI	Rrugë
143	NAZMI HALITI	Rrugë
144	ALUSH KURTESHI	Rrugë
145	QAZIM DOBERDOLANI	Rrugë
146	ZEJNULLAH DOBERDOLANI	Rrugë
147	HAMDI DEMAKU	Rrugë
148	ILAZ S KRASNIQI	Rrugë
149	SHABAN ZEQIRI	Rrugë
150	BAJRAM ZEQIRI	Rrugë
151	SOKOL SH KRASNIQI	Rrugë
152	HASAN H KRASNIQI	Rrugë
153	9 MAJI	Rrugë
154	LATIF SHABANI	Rrugë
155	ARMOND GASHI	Rrugë
156	JAKUP IMER GASHI	Rrugë
157	RRAHMAN JAHA	Rrugë
158	IBISH SOPA	Rrugë
159	MUHAMET THAQI	Rrugë
160	MURAT GASHI	Rrugë
161	SEFER GASHI	Rrugë
162	KAJTAZ KOCA	Rrugë
163	SELIM MIFTARI	Rrugë

164	HASHIM NEBIHI	Rrugë
165	ISLAM E SHAHIN GJELI	Rrugë
166	DINORE AHMETI	Rrugë
167	MARTIRËT ZYMERI	Rrugë
168	REXHEP GJELI	Rrugë
169	HYSNI KRASNIQI	Rrugë
170	ALI SEFERI	Rrugë
171	RAMADAN BAJRAKTARI	Rrugë
172	ISLAM MUJË HASI	Rrugë
173	RAMADAN BEGU	Rrugë
174	AZIZE ZENEL QORRI	Rrugë
175	ZENEL OSMANI	Rrugë
176	IBRAHIM HALILAJ	Rrugë
177	FERIZ LATIF QORRI	Rrugë
178	DEMAJ MEHMETI	Rrugë
179	XHEMAJL B GASHI	Rrugë
180	ASLLAN ZYMBERI	Rrugë
181	HYSEN MULAJ	Rrugë
182	HAJZER BEQIR MULIQI	Rrugë
183	MUHAMET QORRI	Rrugë
184	TAHIR DRENICA	Rrugë
185	BISLIM QORRI	Rrugë
186	AHMET PRENKU	Rrugë
187	ZEQIR TAHIRI	Rrugë
188	SEFER AVDYL THAQI	Rrugë
189	OSMAN KIQINA	Rrugë
190	SEJDI TOPILLA	Rrugë
191	NJAZI ISTOGU	Rrugë
192	MALIQ QORRI	Rrugë
193	LIMAN BUZANI	Rrugë
194	HASAN HETA	Rrugë
195	RIZAH HAJDINAJ	Rrugë
196	ISTREF BUCOLLI	Rrugë
197	SHAQIR VELIQI	Rrugë
198	AVDYL SHAQIRI	Rrugë
199	SELMAN ISTOGU	Rrugë
200	FERIZ HALIMI	Rrugë
201	HAMDI NEBIHI	Rrugë
202	HALIL A AJAZI	Rrugë
203	FADIL XHEKAJ	Rrugë
204	ENVER E ARTON GJINOFCI	Rrugë
205	KADRI SELIMI	Rrugë
206	SALI PAROSHKI	Rrugë
207	HALIM ZEQA	Rrugë
208	NAIM SHALA	Rrugë

209	HALIT SHALA	Rrugë
210	HAJDAR A SHALA	Rrugë
211	KALAJA	Rrugë
212	JUSUF DOBRA	Rrugë
213	ZENË LIMANI	Rrugë
214	ALI H TOGJA	Rrugë
215	AZIZ KRASNIQI	Rrugë
216	HASANAVIT	Rrugë
217	BARDHI	Rrugë
218	NUREDIN HAMITI	Rrugë
219	SADRI HOTI	Rrugë
220	HAJDIN BAJRAMI	Rrugë
221	BAJRAM H NUHA	Rrugë
222	ISUF NIKA	Rrugë
223	IMER KASTRATI	Rrugë
224	QERIM BRAHIMI	Rrugë
225	E MËSUESIT	Rrugë
226	MUHAMET KRASNIQI	Rrugë
227	GURI	Rrugë
228	E SHKOLLËS	Rrugë
229	RIFAT AVDYL THAQI	Rrugë
230	ISMAIL SYLË HASANI	Rrugë
231	VESEL XHEMAJLAJ	Rrugë
232	KODRA	Rrugë
233	E ZABELEVE	Rrugë
234	RRAHMAN GASHI	Rrugë
235	KALAJA E LLAPUSHNIKUT	Rrugë
236	BISLIM AHMATI	Rrugë
237	HETEM CURRI	Rrugë
238	HYSNI SADIKU	Rrugë
239	HAJDIN BRAHIM KASTRATI	Rrugë
240	MUHARREM BAJRAMI	Rrugë
241	OSMAN AJAZI	Rrugë
242	BRAHIM E BEDRI ADEMI	Rrugë
243	AHMET KASTRATI	Rrugë
244	VEHBI RAMADANI	Rrugë
245	FADIL VOKRRI	Rrugë
246	ADEM DEMAÇI	Rrugë
247	ILIRIA	Rrugë
248	HAXHI KLEQKA	Rrugë
249	BESIM GASHI	Rrugë
250	ADEM A GASHI	Rrugë
251	JETMIR BINAKU	Rrugë
252	AVDYL ZEKA	Rrugë
253	REXHEP KASTRIATI	Rrugë

254	LUAN KASTRATI	Rrugë
255	BESIM GASHI	Rrugë
256	DRITON QORRI	Rrugë
257	SHEFQET MUSA	Rrugë
258	ILAZ SH NEZIRI	Rrugë
259	SHTABI UÇK	Rrugë
260	SYLEJMAN TAHIRAJ	Rrugë
261	Nazif Curri	Rrugë
262	Hysni Neziri	Rrugë
Lista Rezervë Paraprake		
261	ADRIATIKU	LISTA REZERVE
262	AHISHTA	LISTA REZERVE
263	AHMET DELIA	LISTA REZERVE
264	ALBANIA	LISTA REZERVE
265	ALBERT AJNSHTAJN	LISTA REZERVE
266	ALBULENA	LISTA REZERVE
267	ALEKSANDËR MOISIU	LISTA REZERVE
268	ALI AJETI	LISTA REZERVE
269	APOLLONIA	LISTA REZERVE
270	ARTA	LISTA REZERVE
271	ASDRENI	LISTA REZERVE
272	BASHKIMI KOMBËTAR	LISTA REZERVE
273	BATALIONI ATLANTIKU	LISTA REZERVE
274	BERATI	LISTA REZERVE
275	BEREQETI	LISTA REZERVE
276	BESËLIDHJA	LISTA REZERVE
277	BILL KLINTON	LISTA REZERVE
278	BOLETINI	LISTA REZERVE
279	BOSTONI	LISTA REZERVE
280	BREGU	LISTA REZERVE
281	BREZA	LISTA REZERVE
282	BRIGJET E LIRISË	LISTA REZERVE
283	BRUKSELI	LISTA REZERVE
284	BUTRINTI	LISTA REZERVE
285	ÇAJUPI	LISTA REZERVE
286	ÇLIRIMI	LISTA REZERVE
287	DEMOKRACIA	LISTA REZERVE
288	DIASPORA	LISTA REZERVE
289	DIELLI	LISTA REZERVE
290	DODONA	LISTA REZERVE
291	DORUNTINA	LISTA REZERVE
292	YLBERI	LISTA REZERVE
293	ZAHIDE JASHARI	LISTA REZERVE
294	KRONI	LISTA REZERVE
295	ARDIANËT	LISTA REZERVE

296	DREJTËSIA	LISTA REZERVE
297	DRITA	LISTA REZERVE
298	DURRËSI	LISTA REZERVE
299	EGNATIA	LISTA REZERVE
300	EPOPEJA UÇK	LISTA REZERVE
301	FITORJA	LISTA REZERVE
302	GJERAVICA	LISTA REZERVE
303	GJERGJ KASTRIOTI	LISTA REZERVE
304	GJYTETI	LISTA REZERVE
305	GRADINA	LISTA REZERVE
306	JETA	LISTA REZERVE
307	KRUJA	LISTA REZERVE
308	LAVDIA E UÇK	LISTA REZERVE
309	LEZHA	LISTA REZERVE
310	SARANDA	LISTA REZERVE
311	MBRETI BARDHYL	LISTA REZERVE
312	MBRETI GENT	LISTA REZERVE
313	MBRETI PIRRO	LISTA REZERVE
314	MEDINA	LISTA REZERVE
315	MEKA	LISTA REZERVE
316	MUJË KRASNIQI	LISTA REZERVE
317	MULLA IDRIZI	LISTA REZERVE
318	NATYRA	LISTA REZERVE
319	QËNDRESA	LISTA REZERVE
320	QYÇAVICA	LISTA REZERVE
321	SHARRI	LISTA REZERVE
322	SHKODRA	LISTA REZERVE
323	SHKUPI	LISTA REZERVE
324	SHOTË GALICA	LISTA REZERVE
325	SHPËTIMI	LISTA REZERVE
326	SHTEGU UÇK	LISTA REZERVE
327	TOMORI	LISTA REZERVE
328	ULQINI	LISTA REZERVE
329	VLERA	LISTA REZERVE
330	VLORA	LISTA REZERVE
331	RILINDJA	LISTA REZERVE
332	16 PRILLI	LISTA REZERVE
333	17 SHKURTI	LISTA REZERVE
334	2 KORRIKU	LISTA REZERVE
335	3 PRILLI	LISTA REZERVE
336	ULPIANA	LISTA REZERVE
337	MILAIM SAHIT BERISHA	LISTA REZERVE

PROCESVERBAL i datës: 24.04.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

PROCESVERBAL NGA TAKIMI ME ZYRTARËT E AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS

Sipas planifikimit, me 24.04.2026 u mbajt takimi me zyrtarët e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, së bashku me Liridonën nga sekretaria e Kuvendit, Besin nga GIS, si dhe anëtarët e komisionit, Qendresën dhe Ekremin.

Ju falënderoj shumë të gjithëve për pjesëmarrjen.

Besoj se kemi marrë informacione të rëndësishme dhe mjaft specifike, të cilat do të na ndihmojnë dukshëm në punën tonë.
Një falënderim i veçantë për Besin për organizimin e këtij takimi.

Ju lus të merrni pjesë të hënën në mbledhjen e thirrur në orën 13:00, ku do të fillojmë shqyrtimin e secilës kërkesë/ankesë.

Fundjavë të këndshme!

PROCESVERBAL i datës: 27.04.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Nga mbledhja e datës 27.04.2026

Mbledhja u mbajt në sallën e bordit të drejtorëve.
Filloi në ora 13:00 dhe përfundoi në ora 15:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm: komisioni i plotë i përbërë nga anëtarët e kuvendit komunal dhe z. Besart Bajrami nga GIS. Në pjesën e fundit të kësaj mbledhjeje mori pjesë edhe znj. Liridona Fejza Ajazi nga sekretaria e kuvendit.

Mbledhja u hap nga kryesuesi, i cili në fillim i njoftoi të gjithë anëtarët e komisionit për takimin me zyrtarët e Agjencisë Kadastrale të Kosovës (në vazhdim: AKK), me qëllim që puna e komisionit të zhvillohet në përputhje me udhëzimet (bazën ligjore) të rekomanduara nga zyrtarët e AKK-së.

U theksua nevoja që të vazhdohet puna në përputhje me ligjin, duke u bazuar në Listën rezervë sipas Udhëzimit Nr. 17/2019. Gjithashtu, u propozua që të gjitha kërkesat, pa marrë parasysh vitin të cilit i përkasin, të ndahen sipas fshatrave. Ky propozim u miratua dhe u zbatua.

Meqenëse selektimi i kërkesave/ankesave mori shumë kohë, komisioni arriti të fillojë vetëm shqyrtimin e një kërkese të fshatit Abri (me dakordim paraprak që shqyrtimi të fillojë në bazë të alfabetit për secilin fshat), duke e analizuar në monitor rrugën përkatëse, por pa e proceduar më tej për shkak të kohës së kufizuar.

Mbledhja e radhës u caktua për të hënën e ardhshme, në të njëjtin vend dhe në të njëjtën orë. Paraprakisht, komisioni u dakordua që çdo të hënë, në këtë orar, të mbahet takim i rregullt pune.

PROCESVERBAL i datës: 04.05.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Mbledhja filloi në ora 13:20 dhe përfundoi në ora 15:00.

Prezent ishin anëtarët e komisionit:
- Qendresa Xhema
- Luljeta Elshani
- Xhavit Drenori

Ndërsa nga GIS ishte prezent:
- Besart Bajrami

Menjëherë komisioni filloi trajtimin e secilës kërkesë/ankesë të fshatit Abri. Gjatë shqyrtimit të kërkesave/ankesave të parashtruara, në disa raste u paraqit nevoja që të kontaktohej edhe administratori i fshatit Abri.

Të gjitha kërkesat/ankesat e shqyrtuara, së bashku me emrin e parashtruesit të kërkesës, emrin e propozuar si dhe vendimin për aprovim ose mosaprovim (kjo e fundit e shoqëruar me arsyetimin përkatës), do të jenë të përgatitura për takimin e radhës, i cili do të mbahet të martën, më 12 maj, nga ora 13:10, në të njëjtën sallë.

Më pas, komisioni vazhdoi me shqyrtimin e disa kërkesave/ankesave të fshatit Arllat, ku gjithashtu në disa raste u paraqit nevoja që të rikontaktohej administratori i fshatit.

Në përfundim të mbledhjes, anëtarët u ndanë përgjithësisht të kënaqur, pasi me dakordim të plotë u arrit që procesi të shtyhet përpara dhe të vihet në binarë të qëndrueshëm.

Në fshatin Arllat u paraqit nevoja për një javë kohë shtesë për disa segmente, në mënyrë që propozimet të rishqyrtohen dhe të rikthehen në koordinim me lagjet. Shqyrtimi për këtë fshat do të vazhdojë të martën e ardhshme.

PROCESVERBAL i datës: 18.05.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Nga mbledhja e datës 18.05.2026

Të pranishëm:

Anëtarët e komisionit:

* Luljeta Elshani
* Ekrem Elshani
* Artian Krasniqi
* Xhavit Drenori

Nga GIS:

* Besart Bajrami

Gjatë punimeve të komisionit kanë ardhur edhe anëtarët e Kuvendit Komunal, Burim Bujupi dhe Valdet Curri, në cilësinë e vëzhguesve.

Takimi filloi në ora 13:15 dhe përfundoi në ora 14:45.

Takimi filloi me shqyrtimin e kërkesave/ankesave të fshatit Arllat, të cilat kishin mbetur pa u trajtuar nga mbledhja e fundit. Gjatë shqyrtimit të rasteve u paraqit nevoja që shpesh të thirrej kryetari i fshatit Arllat për sqarime shtesë, si dhe parashtruesit e kërkesave. Paqartësitë ishin kryesisht tek segmentimi, meqë kishte shumë rrugica dhe segmente të ndryshme. Në këtë drejtim, anëtarët e Kuvendit Komunal, si pjesëmarrës vëzhgues, ndihmuan në qartësimin e saktë të segmenteve për të cilat bëhej fjalë.

Raporti lidhur me kërkesat/ankesat e pranuara dhe të refuzuara është mbajtur shënim për secilën rast, jo vetëm nga kryesuesi i komisionit, por edhe nga zyrtari i GIS-it, i cili menjëherë i ka evidentuar dhe shënuar në sistem.

Më pas u vazhdua edhe me disa kërkesa të mbetura nga fshatrat Bytyq dhe Gjergjicë, të cilat gjithashtu janë mbajtur në shënim për vendimet e komisionit lidhur me to.

Meqë javën e kaluar, për shkaqe objektive, nuk u mbajt asnjë takim, u propozua që gjatë kësaj jave të takohemi përsëri, të enjten nga ora 13:10, në të njëjtën sallë, për të vazhduar me shqyrtimin e kërkesave/ankesave të fshatrave dhe lokaliteteve të tjera të mbetura.

Procesverbali u hartua dhe u përmbyll në shenjë konfirmimi të zhvillimit të takimit.

PROCESVERBAL i datës: 21.05.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Mbledhja filloi në ora 13:25 dhe përfundoi në ora 14:25.

Të pranishëm:

Anëtarët e Komisionit nga Kuvendi Komunal:

* Qendresa Xhema
* Luljeta Elshani
* Xhavit Drenori

Pjesëmarrës nga GIS:

* Besart Bajrami

Gjatë shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave ishte i pranishëm edhe administratori i fshatit Baicë, z. Semedin Kiçina, i cili rastësisht ishte ndodhur në objektin e komunës në momentin kur u kërkuan sqarime lidhur me segmente të caktuara në fshatin Baicë. I njëjti qëndroi pranë komisionit gjatë shqyrtimit të të gjitha rasteve që kishin të bënin me fshatin Baicë, duke ofruar sqarimet e nevojshme sipas kërkesës.

Më pas u shqyrtuan edhe kërkesat e fshatit Dobroshec. Gjatë kësaj ore pune u arrit të përfundohet shqyrtimi i rasteve për dy fshatra: Baicë dhe Dobroshec.

Komisioni u dakordua që takimi i radhës të mbahet të hënën, duke filluar nga ora 13:10, në të njëjtën sallë.

Në fund, u shpreh falënderim i veçantë për të gjithë pjesëmarrësit për angazhimin dhe punën e palodhshme gjatë procesit të shqyrtimit.

PROCESVERBAL i datës: 25.05.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Data: 25.05.2026
Koha e fillimit: 13:15
Koha e përfundimit: 14:45

Sot, më datë 25.05.2026, u mbajt mbledhja e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve në komunën tonë, e cila filloi në ora 13:15 dhe përfundoi në ora 14:45.

Anëtarët e pranishëm të Komisionit të Kuvendit Komunal:

* Qendresa Xhema
* Ekrem Elshani
* Xhavit Drenori

I pranishëm nga GIS:

* Besart Bajrami

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve në komunën tonë vazhdoi punën me shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave nga fshatrat Domanek dhe Gllanasellë.

Kërkesat për Drenasin I, II dhe III u shtynë, me qëllim që në mbledhjen e ardhshme të jetë i pranishëm një numër më i madh i anëtarëve të komisionit, për shkak të ndjeshmërisë, interesit më të madh dhe numrit të konsiderueshëm të kërkesave dhe ankesave.

Si në Domanek, ashtu edhe në Gllanasellë, kishte kërkesa që datonin që nga viti 2017, si dhe mungesë të sqarimeve të nevojshme lidhur me segmentet përkatëse, gjë që e vështirësoi shqyrtimin e disa rasteve.

Për sqarime shtesë u thirrën edhe palët përkatëse, si dhe kryetari i fshatit Gllanasellë, në disa raste gjatë shqyrtimit.

Pas shqyrtimit, disa nga kërkesat u aprovuan, ndërsa disa u refuzuan. Për secilin refuzim është bërë shënim adekuat me arsyetimin përkatës.

Anëtarët e komisionit u dakorduan që mbledhja e ardhshme të mbahet të martën e javës së ardhshme, më 02 qershor 2026, duke filluar nga ora 13:10, në sallën tjetër.

PROCESVERBAL i datës: 04.06.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Nga mbledhja e Komisionit për Emërtimin e Rrugëve

Data: 04.06.2026
Vendi: Salla e mbledhjës së Bordit
Koha e fillimit: 10:00
Koha e përfundimit: 12:10

Të pranishëm:

Anëtarët e Komisionit:

* Qendresa Xhema
* Luljeta Elshani
* Ekrem Elshani
* Xhavit Drenori

Nga GIS:

* Besart Bajrami

Rendi i punës

Komisioni vazhdoi me shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të banorëve të fshatit Gllanasellë lidhur me emërtimin e rrugëve.

Gjatë shqyrtimit u konstatua se numri i kërkesave/ankesave ishte i madh dhe se në disa raste kishte paqartësi lidhur me segmentet rrugore. Për këtë arsye, gjatë mbledhjes u paraqit nevoja për komunikim të shpeshtë telefonik me administratorin e fshatit dhe me palët e përfshira, me qëllim të sqarimit të rrethanave dhe verifikimit të informatave të nevojshme.

Komisioni evidentoi dy (2) kërkesa të cilat mbetën të paqarta dhe për të cilat nevojiten sqarime shtesë. Ndërkaq, për të gjitha kërkesat dhe ankesat e tjera u morën vendimet përkatëse, duke u dhënë përgjigje dhe sqarime të arsyetuara në rastet e refuzimit.

Përfundim

Pas diskutimeve, Komisioni u dakordua që të vazhdojë punën në mbledhjen e radhës, e cila pritet të mbahet javën e ardhshme, potencialisht të martën.

PROCESVERBAL i datës: 09.06.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Data: 09.06.2026
Koha e fillimit: 13:10
Koha e përfundimit: 15:00

Pjesëmarrësit

Anëtarët e Komisionit (Kuvendi Komunal):

* Luljeta Elshani
* Artian Krasniqi
* Xhavit Drenori

Përfaqësues nga GIS:

* Besart Bajrami

Rendi i punës dhe shqyrtimi i çështjeve

Mbledhja filloi në orën 13:10 me shqyrtimin e kërkesave/ankesave nga fshati Gllanasellë. U trajtuan dy kërkesa të mbetura nga mbledhja e kaluar, të cilat kishin qenë të paqarta. Në komunë dje ishin të pranishme edhe palët përkatëse, me ç'rast u sqaruan segmentet përkatëse dhe u bë trajtimi i tyre.

Më pas, Komisioni vazhdoi me shqyrtimin e lëndëve për fshatin Gllobar. Me ndihmën e administratorit të fshatit u shqyrtuan dhe u përpunuan të gjitha kërkesat dhe ankesat e paraqitura.
Në përputhje me rregulloren në fuqi, kërkesat u miratuan ose u refuzuan sipas kritereve përkatëse.

Në të njëjtën mënyrë u procedua edhe me kërkesat dhe ankesat nga fshatrat Sankoc dhe Fushticë. Përmes komunikimit telefonik me administratorët përkatës të këtyre fshatrave, Komisioni arriti të shqyrtojë dhe përpunojë të gjitha rastet e paraqitura.

Komisioni konstatoi se janë trajtuar të gjitha çështjet e parapara për këtë mbledhje dhe u dakordua që mbledhja e radhës të mbahet të martën e ardhshme, në të njëjtën kohë.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

PROCESVERBAL i datës: 16.06.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Data: 16.06.2026
Vendi i mbajtjes: Salla e mbledhjeve të bordit.
Koha e fillimit: 13:10
Koha e përfundimit: 15:00

Të pranishëm në mbledhje:

Nga Kuvendi Komunal – anëtarë të Komisionit:

* Qendresa Xhema
* Luljeta Elshani

* Xhavit Drenori

Nga GIS:

* Besart Bajrami

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të mbetura lidhur me emërtimin e rrugëve dhe rrugicave në Komunën e Drenasit.

Ecuria e mbledhjes:

Mbledhja e Komisionit filloi në ora 13:10, ku anëtarët e Komisionit filluan me shqyrtimin e lëndëve të mbetura për fshatrat Fushticë dhe Sankoc.

Pas përfundimit të shqyrtimit të këtyre lëndëve, puna vazhdoi me shqyrtimin e kërkesave për fshatrat Çikatovë e Vjetër dhe Çikatovë e Re.

Gjatë shqyrtimit të lëndëve u paraqit nevoja për kontaktimin e parashtruesve të kërkesave përmes telefonit, me qëllim të marrjes së sqarimeve shtesë dhe plotësimit të informatave të nevojshme për vendimmarrje.

Në vazhdim, Komisioni vazhdoi punën me shqyrtimin e kërkesave për fshatin Nekoc. Për shkak të numrit të madh të lëndëve të paraqitura për këtë fshat, nuk u arrit që të shqyrtohen të gjitha kërkesat gjatë kësaj mbledhjeje.

Në fund të mbledhjes u dakordua që mbledhja e radhës e Komisionit të mbahet të martën e ardhshme, duke filluar nga ora 13:10, në të njëjtën sallë.

Mbledhja përfundoi në ora 15:00.

PROCESVERBAL i datës: 23.06.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Data: **23.06.2026**
Vendi i mbajtjes: Salla e mbledhjeve
Koha e fillimit: 13:10
Koha e përfundimit: 15:00

Të pranishëm në mbledhje:

Nga Kuvendi Komunal – anëtarë të Komisionit:

* Qendresa Xhema
* Ekrem Elshani

* Xhavit Drenori

Nga GIS:

* Besart Bajrami

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të mbetura lidhur me emërtimin e rrugëve dhe rrugicave në Komunën e Drenasit.

Ecuria e mbledhjes:

Mbledhja e Komisionit filloi në ora 13:10, ku anëtarët e Komisionit vazhduan me shqyrtimin e lëndëve të mbetura për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave.

Gjatë kësaj mbledhjeje u shqyrtuan dhe u përpunuan kërkesat për fshatrat Nekoc dhe Shtuticë.

Gjatë shqyrtimit të lëndëve u analizuan kërkesat e paraqitura dhe, kur ishte e nevojshme, u evidentua nevoja për sqarime shtesë nga parashtruesit e kërkesave përmes kontaktimit të tyre, me qëllim të kompletimit të informatave të nevojshme.

Komisioni vazhdoi punën sipas planit të shqyrtimit të lëndëve të mbetura.

Në fund të mbledhjes u dakordua që mbledhja e radhës e Komisionit të mbahet këtë javë, të enjten, duke filluar nga ora 13:10, në të njëjtën sallë.

PROCESVERBAL i datës: 25.06.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Data: **25.06.2026**
Vendi: Salla e Bordit
Ora e fillimit: 13:15
Ora e përfundimit: 14:45

Të pranishëm nga Komisioni i Kuvendit Komunal:

* Qendresa Xhema
* Ekrem Elshani
* Xhavit Drenori

Nga GIS:

* Besart Bajrami

Rendi i ditës:

1. Trajtimi i kërkesave dhe ankesave të pranuara lidhur me emërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Drenasit.

Zhvillimi i mbledhjes:

Komisioni për Emërtimin e Rrugëve vazhdoi punën me shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të parashtruara nga fshatrat: Terdec, Vasilevë, Vuçak dhe Zabel i Epërm.

Gjatë shqyrtimit të rasteve të paraqitura, komisioni analizoi segmentet e propozuara dhe kërkesat përkatëse, duke u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, gjendjen në terren dhe dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Nga fshati Zabel i Epërm, disa raste mbetën për t'u trajtuar në mbledhjen e ardhshme për shkak të paqartësive lidhur me disa segmente të rrugëve dhe nevojës për sqarime shtesë.

Gjatë trajtimit të kërkesave dhe ankesave, në disa raste u paraqit nevoja për kontaktim telefonik me parashtruesit e kërkesave/ankesave, si dhe me kryetarët e fshatrave, me qëllim të sqarimit të segmenteve dhe marrjes së informatave shtesë.

Edhe në këtë mbledhje, komisioni mori vendime për aprovim dhe refuzim të kërkesave, në përputhje me kriteret dhe legjislacionin në fuqi.

Të gjitha rastet e shqyrtuara janë evidentuar në tabelat përkatëse, së bashku me sqarimet dhe vërejtjet e nevojshme për secilin rast.

Mbledhja e radhës u dakordua të mbahet të martën e javës së ardhshme, duke filluar nga ora 13:10, në të njëjtën sallë.

Mbledhja përfundoi në ora 14:45.

PROCESVERBAL i datës: 14.07.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Data: 14.07.2026
Koha e fillimit: 13:20
Koha e përfundimit: 14:45
Vendi: Salla e mbledhjeve

Të pranishëm

Anëtarët e Komisionit / Asamblistët:

* Qendresa Xhema
* Ekrem Elshani

* Artian Krasniqi
* Xhavit Drenori

Përfaqësues nga GIS:

* Besart Bajrami

Rendi i punës

Komisioni vazhdoi shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave lidhur me emërtimin e rrugëve për fshatrat Zabel i Poshtëm dhe Poklek.

Në fillim të mbledhjes u vendos që rastet e Zabelit të Epërm të shtyhen për mbledhjen e radhës, për shkak të paqartësive të evidentuara gjatë shqyrtimit. U dakordua që në mbledhjen e ardhshme të jetë i pranishëm edhe kryetari i fshatit, me qëllim të sqarimit të çështjeve të ngritura.

Pas përfundimit të shqyrtimit të rasteve për fshatrat e lartpërmendura, komisioni filloi shqyrtimin e rasteve të fshatit Verboc. Megjithatë, për shkak të numrit të madh të rasteve të trajtuara, si dhe nevojës që në disa raste të kontaktoheshin palët për sqarime shtesë, komisioni vendosi që puna të vazhdojë nga pika ku mbeti.

Mbledhja e radhës u caktua të mbahet të enjten e kësaj jave, datë 16.07.2026, duke filluar nga ora 13:10, në të njëjtën sallë.

PROCESVERBAL i datës: 16.07.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Data: 16.07.2026
Koha e fillimit: 13:20
Koha e përfundimit: 14:55
Vendi: Salla e bordit

Të pranishëm

Anëtarët e Komisionit / Asamblistët:

- Qendresa Xhema
- Ekrem Elshani
- Artian Krasniqi
- Xhavit Drenori

Përfaqësues nga GIS:

- Besart Bajrami

Komisioni vazhdoi shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave lidhur me emërtimin e rrugëve për fshatin Zabel i Epërm. Gjatë gjithë kohës së shqyrtimit të rasteve, komisioni u asistua nga administratori i fshatit, i cili ofroi sqarime dhe informacione shtesë për çështjet e trajtuara.

Pas përfundimit të shqyrtimit të rasteve për fshatin Zabel i Epërm, komisioni vazhdoi me shqyrtimin e rasteve të fshatit Verboc, duke analizuar kërkesat dhe ankesat e paraqitura.

Gjatë mbledhjes, anëtarët e komisionit u dakorduan që, me qëllim të përshpejtimit të procesit të shqyrtimit të rasteve, mbledhjet e Komisionit për Emërtimin e Rrugëve të mbahen dy herë në javë, përkatësisht çdo të martë dhe të enjte, në të njëjtën orë dhe në të njëjtën sallë të mbledhjeve.

PROCESVERBAL i datës: 22.07.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Data: 22.07.2026
Koha e fillimit: 13:20
Koha e përfundimit: 15:30

Të pranishëm

Anëtarët e Komisionit / Asamblistët:

- Ekrem Elshani
- Artian Krasniqi
- Xhavit Drenori

Përfaqësues nga GIS:

- Besart Bajrami

Komisioni shqyrtoi dy kërkesa të paraqitura nga fshati Verboc, duke analizuar dokumentacionin përkatës dhe duke marrë qëndrimet e nevojshme për secilin rast.

Pas përfundimit të shqyrtimit të këtyre kërkesave, komisioni vazhdoi me trajtimin e kërkesave dhe ankesave të shumta të fshatit Tërstenik.
Gjatë gjithë kohës së shqyrtimit të rasteve, komisioni u asistua nga administratori i fshatit, i cili ishte i pranishëm në mbledhje dhe ofroi sqarime e informacione shtesë për secilën çështje të trajtuar. Me ndihmën e tij, komisioni arriti t'u japë epilog të gjitha kërkesave dhe ankesave të shqyrtuara.

Komisioni u dakordua që mbledhja e radhës të mbahet të martën, më 28.07.2026, në ora 13:15, në të njëjtën sallë të mbledhjeve.

PROCESVERBAL i datës: 28.07.2016

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Data: 28.07.2026
Koha e fillimit: 13:15
Koha e përfundimit: 15:00
Vendi: Salla e bordit

Të pranishëm

Anëtarët e Komisionit / Asamblistët:

* Luljeta Elshani
* Ekrem Elshani
* Artian Krasniqi
* Xhavit Drenori

Përfaqësues nga GIS:

* Besart Bajrami

Komisioni vazhdoi punën me shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të paraqitura nga fshati Komoran. Për shkak të numrit të madh të rasteve të paraqitura, nuk u arrit që të gjitha kërkesat dhe ankesat të shqyrtohen dhe të marrin epilog gjatë kësaj mbledhjeje.

Paraprakisht, në mbledhje ishte i pranishëm kryetari i fshatit Poklek, i cili shprehu pakënaqësi lidhur me trajtimin e rasteve të këtij fshati. Komisioni sqaroi secilin rast të paraqitur për fshatin Poklek, duke theksuar se të gjitha kërkesat dhe ankesat e këtij fshati ishin shqyrtuar dhe përfunduar në mbledhjet paraprake.

Komisioni u dakordua që mbledhja e radhës të mbahet të martën e ardhshme, në ora 13:15, në të njëjtin vend, me qëllim të vazhdimit të shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave të mbetura nga fshati Komoran.

PROCESVERBAL i datës: 04.08.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Data: 04.08.2026
Koha e fillimit: 13:45
Koha e përfundimit: 15:00
Vendi: Salla e bordit

Të pranishëm

Anëtarët e Komisionit / Asamblistët:

* Qendresa Xhema
* Artian Krasniqi
* Xhavit Drenori

Përfaqësues nga GIS:

* Besart Bajrami

Komisioni filloi punën me vonesë për shkak të vonesës së koleges Qendresa Xhema, e cila kishte njoftuar me kohë për këtë vonesë.

Komisioni vazhdoi punën me shqyrtimin e rasteve të fshatit Komoran, ku u paraqit nevoja për të kontaktuar telefonikisht kryetarin e këtij lokacioni, me qëllim të marrjes së sqarimeve shtesë lidhur me segmentet e propozuara.

Pas përfundimit të shqyrtimit të rasteve të Komoranit, komisioni përmbylli edhe shqyrtimin e të gjitha kërkesave dhe ankesave të fshatit Kishnarekë.

Komisioni u dakordua që mbledhja e radhës të mbahet këtë javë, të enjten, në ora 13:15, në të njëjtën sallë, me qëllim të vazhdimit të punës sipas agjendës.

PROCESVERBAL i datës: 06.08.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Data: 06.08.2026
Koha e fillimit: 13:15
Koha e përfundimit: 15:00
Vendi: Salla e bordit

Të pranishëm

Anëtarët e Komisionit / Asamblistët:

* Luljeta Elshani
* Qendresa Xhema
* Ekrem Elshani
* Artian Krasniqi
* Xhavit Drenori

Përfaqësues nga GIS:

* Besart Bajrami

Komisioni filloi punën duke shqyrtuar kërkesat dhe ankesat e fshatit Negroc. Në mbledhje ishte i pranishëm edhe kryetari i fshatit, i cili asistoi komisionin me sqarimet e nevojshme lidhur me rastet e trajtuara.

Pas përfundimit të shqyrtimit të rasteve të fshatit Negroc, komisioni vazhdoi me shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të fshatrave Krajkovë, Likoshan, Korroticë e Epërme dhe Korroticë e Poshtme.

Komisioni u dakordua që mbledhja e radhës të mbahet të martën e ardhshme, në ora 13:15, në të njëjtën sallë, me qëllim të vazhdimit të punës sipas agjendës.

PROCESVERBAL i datës: 11.08.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Data: 11.08.2026
Koha e fillimit: 13:15
Koha e përfundimit: 15:00
Vendi: Salla e Bordit

Të pranishëm

Anëtarët e Komisionit / Asamblistët:

* Luljeta Elshani
* Ekrem Elshani
* Xhavit Drenori

Përfaqësues nga GIS:

* Besart Bajrami

Mbledhja e Komisionit filloi me vazhdimin e shqyrtimit të disa kërkesave dhe ankesave të parashtruara nga be e fshatit Korroticë e Epërme.

Pas përfundimit të shqyrtimit të rasteve të mbetura nga fshati Korroticë e Epërme, Komisioni vazhdoi me shqyrtimin e të gjitha kërkesave dhe ankesave të parashtruara nga banorët e fshatit Shtrubullovë. Të gjitha kërkesat dhe ankesat e këtij fshati u shqyrtuan dhe procedimi i tyre përfundoi.

Komisioni u dakordua që mbledhja e radhës të mbahet të martën e ardhshme, në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend, për të vazhduar punën sipas agjendës së përcaktuar.

Mbledhja përfundoi në ora 15:00.

PROCESVERBAL i datës: 18.08.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Data: 18.08.2026
Koha e fillimit: 13:30
Koha e përfundimit: 15:45
Vendi: Salla e Bordit

Të pranishëm

Anëtarët e Komisionit / Asamblistët:

* Qendresa Xhema
* Artian Krasniqi
* Ekrem Elshani
* Xhavit Drenori

Nga GIS:
• Besart Bajrami

Mbledhja e Komisionit filloi me shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të parashtruara nga banorët e fshatit Llapushnik.

Gjatë mbledhjes, Komisioni trajtoi vetëm kërkesat dhe ankesat e fshatit Llapushnik, duke shqyrtuar rastet e paraqitura dhe duke diskutuar lidhur me to.

Komisioni u dakordua që mbledhja e radhës të mbahet më 25.08.2026, në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend, për të vazhduar punën sipas agjendës së përcaktuar.

Mbledhja përfundoi në ora 15:45.

PROCESVERBAL i datës: 02.09.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Data: 02.09.2026
Koha e fillimit: 13:30
Koha e përfundimit: 15:00
Vendi: Salla e Bordit

Të pranishëm

Anëtarët e Komisionit / Asamblistët:

* Qendresa Xhema
* Artian Krasniqi

* Xhavit Drenori

Nga GIS:

* Besart Bajrami

Ecuria e mbledhjes

Mbledhja e Komisionit për Emërtimin e Rrugëve filloi me shqyrtimin dhe trajtimin e kërkesave dhe ankesave të parashtruara nga banorët e fshatit Llapushnik.

Gjatë mbledhjes, Komisioni përpunoi dhe shqyrtoi kërkesat dhe ankesat e fshatit Llapushnik, duke trajtuar rastet e paraqitura dhe duke diskutuar lidhur me to.

Pas përfundimit të kësaj pjese të punës, Komisionit i kanë mbetur për shqyrtim kërkesat dhe ankesat e lagjeve urbane të Drenasit, ndërsa më pas do të vazhdohet me shqyrtimin e kërkesave të reja.

Me qëllim të përshpejtimit të procesit të punës dhe përfundimit sa më efikas të agjendës, Komisioni u dakordua që mbledhja e radhës të mbahet të premten, më 04.09.2026, duke filluar nga ora 13:15, në të njëjtën sallë.

PROCESVERBAL i datës: 04.09.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Data: 04.09.2026
Koha e fillimit: 13:30
Koha e përfundimit: 15:00
Vendi: Salla e Bordit

Të pranishëm

Anëtarët e Komisionit / Asamblistët:

* Qendresa Xhema
* Luljeta Elshani
* Ekrem Elshani
* Artian Krasniqi
* Xhavit Drenori

Përfaqësues nga GIS:

* Besart Bajrami

Në fillim të mbledhjes, së bashku me asamblistin Naim Gjeli, u trajtuan disa kërkesa të parashtruara nga Këshilli i fshatit Likoshan.

Pas përfundimit të trajtimit të këtyre kërkesave, Komisioni vazhdoi me shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të parashtruara nga lagjet e Drenasit.

Duke pasur parasysh volumin e madh të kërkesave dhe ankesave, shqyrtimi i tyre nuk arriti të përfundojë në këtë mbledhje. Komisioni vlerësoi se është e nevojshme që puna të vazhdojë edhe në mbledhjen e radhës.

Komisioni u dakordua që mbledhja e radhës të mbahet të martën, më 08.09.2026, në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend, me qëllim të vazhdimit të shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave të mbetura.

Mbledhja përfundoi në ora 15:00

PROCESVERBAL i datës: 15.09.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Data: 15.09.2026
Koha e fillimit: 13:15
Koha e përfundimit: 15:00
Vendi: Salla e Bordit

Të pranishëm

Anëtarët e Komisionit / Asamblistët:

* Qendresa Xhema
* Ekrem Elshani
* Artian Krasniqi
* Xhavit Drenori

Përfaqësues nga GIS:

* Besart Bajrami

Mbledhja e Komisionit filloi me shqyrtimin e kërkesave të parashtruara nga banorët e Drenasit, përkatësisht të kërkesave të klasifikuara në folderin "Drenasi (Qendër)".

Gjatë mbledhjes, Komisioni shqyrtoi dhe trajtoi kërkesat e përfshira në këtë folder, të cilat u përfunduan me sukses.

Në vijim, u konstatua se kanë mbetur edhe disa kërkesa të tjera, të cilat janë vendosur në folderin "Drenasi", dhe të cilat do të shqyrtohen para se Komisioni të kalojë në folderin e fundit, që përmban kërkesat e parashtruara gjatë këtij viti.

Duke pasur parasysh se dita e nesërme është një datë e shënuar dhe duke marrë parasysh zhvillimet e parapara për nesër, Komisioni vlerësoi se vazhdimi i shqyrtimit të kërkesave do të caktohet eventualisht për ditën e enjte, në ora 15:10.

Mbledhja përfundoi në ora 15:00.

PROCESVERBAL i datës: 22.09.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Data: 22.09.2026
Koha e fillimit: 13:15
Koha e përfundimit: 15:00
Vendi: Salla e Bordit

Të pranishëm

Anëtarët e Komisionit / Asamblistët:

* Luljeta Elshani
* Qendresa Xhema
* Xhavit Drenori

Përfaqësues nga GIS:

* Besart Bajrami

Zhvillimi i mbledhjes

Mbledhja e Komisionit për Emërtimin e Rrugëve filloi në ora 13:15.

Gjatë mbledhjes u shqyrtuan dhe u trajtuan kërkesa të reja për emërtimin e rrugëve dhe lokacioneve të ndryshme, të parashtruara gjatë këtij viti.

Komisioni diskutoi për kërkesat e paraqitura dhe vazhdoi punën në shqyrtimin e tyre, me qëllim të përfundimit të procesit të trajtimit dhe evidentimit të propozimeve përkatëse.

Pas konfirmimit se ekziston mundësia për zhvillimin e një mbledhjeje tjetër ditën e nesërme, u dakordua që puna e Komisionit të vazhdojë nesër, më 23.09.2026 (e mërkurë), me shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesave.

Mbledhja përfundoi në ora 15:00.

PROCESVERBAL i datës: 23.09.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Data: 23.09.2026
Koha e fillimit: 13:15
Koha e përfundimit: 15:00
Vendi: Salla e Bordit

Të pranishëm

Anëtarët e Komisionit / Asamblistët:

* Luljeta Elshani
* Qendresa Xhema
* Artian Krasniqi
* Xhavit Drenori

Përfaqësues nga GIS:

* Besart Bajrami

Zhvillimi i mbledhjes

Mbledhja e Komisionit për Emërtimin e Rrugëve filloi në ora 13:15.

Gjatë mbledhjes, fillimisht u shqyrtuan disa kërkesa të mëhershme të mbetura nga mbledhja e Komisionit në të cilën ishin trajtuar rastet për zonën e Drenasit. Pas përfundimit të shqyrtimit të këtyre kërkesave, Komisioni vazhdoi me trajtimin e kërkesave të reja për emërtimin e rrugëve dhe lokacioneve të ndryshme, të parashtruara gjatë këtij viti.

Komisioni diskutoi dhe shqyrtoi kërkesat e paraqitura, duke vazhduar punën në evidentimin dhe trajtimin e propozimeve përkatëse. Puna e Komisionit është duke shkuar drejt përfundimit të procesit të shqyrtimit të kërkesave.

Duke pasur parasysh se gjatë kësaj jave është paraparë edhe mbajtja e mbledhjes së Kuvendit, u propozua që mbledhja e radhës e Komisionit të mbahet të martën e javës së ardhshme, në të njëjtën orë dhe në të njëjtin vend.

Mbledhja përfundoi në ora 15:00.

PROCESVERBAL i datës: 29.09.2026

KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE ANKESAVE TË PALËVE PËR EMËRTIM TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Data: 29.09.2026
Koha e fillimit: 13:15

Koha e përfundimit: 14:50
Vendi: Salla e Bordit

Të pranishëm

Anëtarët e Komisionit / Asamblistët:

* Luljeta Elshani
* Artian Krasniqi
* Xhavit Drenori

Përfaqësues nga GIS:

* Besart Bajrami

Zhvillimi i mbledhjes

Mbledhja e Komisionit për Emërtimin e Rrugëve filloi në ora 13:15.

Gjatë mbledhjes, Komisioni vazhdoi me shqyrtimin dhe trajtimin e kërkesave të mbetura nga mbledhjet e mëhershme. Gjatë kësaj mbledhjeje u përfunduan pothuajse të gjitha kërkesat e mbetura, duke avancuar kështu drejt përmbylljes së procesit të shqyrtimit të tyre.

Megjithatë, Komisioni vlerësoi se në mbledhjen e radhës duhet të bëhet edhe një verifikim përfundimtar në zyrën e Kuvendit, me qëllim që të konstatohet nëse ka mbetur edhe ndonjë kërkesë e pa trajtuar.

Njëkohësisht, në mbledhjen e radhës do të bëhet verifikimi i emërtimeve të evidentuara në shënimet elektronike të kryesuesit dhe të Besart Bajramit, në platformën përkatëse, duke i lexuar dhe kontrolluar emrat një nga një në prani të anëtarëve të Komisionit, me qëllim të shmangies së çdo pasaktësie në emërtime dhe në listën përfundimtare.

Komisioni propozoi që kjo mbledhje përfundimtare të mbahet të premten, më 02.10.2026, në të njëjtin vend dhe në të njëjtën orë.

Pas përfundimit të këtij verifikimi, kryesuesi i Komisionit do të përpilojë një raport/shabllon të punës së Komisionit, i cili do t'u përcillet anëtarëve të Komisionit për shqyrtim dhe vërejtje. Pas harmonizimit të tij, raporti do të finalizohet dhe do të përcillet për shqyrtim në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në ora 14:50.

Data: 02.10.2026
Koha e fillimit: 13:15
Koha e përfundimit: 15:00
Vendi: Salla e Bordit

Të pranishëm

Përfaqësues nga Kuvendi / Anëtarët e Komisionit:

* Qendresa Xhema
* Ekrem Elshani
* Xhavit Drenori

Përfaqësues nga GIS:

* Besart Bajrami

Zhvillimi i mbledhjes

Mbledhja e Komisionit për Emërtimin e Rrugëve u mbajt më 02.10.2026, duke filluar në ora 13:15, në Sallën e Bordit.

Gjatë kësaj mbledhjeje, Komisioni shqyrtoi edhe disa kërkesa të reja të pranuara gjatë ditëve të fundit. Pas shqyrtimit të tyre, anëtarët u dakorduan që të bëhet leximi me zë i të gjithë emrave të rrugëve të miratuara, me qëllim të krahasimit dhe verifikimit të përputhshmërisë së tyre me shënimet e mbajtura nga anëtarët e Kuvendit dhe nga përfaqësuesi i GIS-it, Besart Bajrami.

Gjatë këtij verifikimi u evidentuan disa emërtime, gjithsej deri në pesë (5), për të cilat u vlerësua se nevojitet një kontroll shtesë me kryetarët e fshatrave përkatës. Bëhet fjalë për raste kur janë vërejtur dallime të vogla në shkrimin e emrave, përkatësisht në përdorimin e ndonjë shkronje. Ky verifikim shtesë synon të sigurojë saktësinë e emërtimeve dhe përputhshmërinë e tyre me emrat e përdorur në terren.

Pas përfundimit të shqyrtimit dhe verifikimit të listës, Komisioni konstatoi se puna e tij lidhur me shqyrtimin e kërkesave dhe harmonizimin e emërtimeve të rrugëve është përmbyllur, me përjashtim të verifikimit të kufizuar të emrave të evidentuar më lart.

Në vijim, kryesuesi i Komisionit do të përpilojë draft-raportin përfundimtar të punës së Komisionit, në të cilin do të përfshihen emërtimet e miratuara të rrugëve. Draft-raporti do t'u përcillet të gjithë anëtarëve për shqyrtim, vërejtje dhe harmonizim të përbashkët. Pas dakordimit për përmbajtjen përfundimtare, raporti, së bashku me listën e emrave të miratuar të rrugëve, do të dorëzohet në Sekretari, për t'u proceduar më pas për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe, më pas, në Kuvend.

Në përfundim të mbledhjes, kryesuesi falënderoi të gjithë anëtarët e Komisionit dhe përfaqësuesin e GIS-it për punën e përbashkët, angazhimin, bashkëpunimin dhe

kolegialitetin e treguar gjatë gjithë procesit. Ai shprehu mirënjohjen e veçantë për besimin e dhënë për udhëheqjen e punës së Komisionit, duke vlerësuar lart frymën e mirë të bashkëpunimit, pavarësisht dallimeve politike.

Gjithashtu, u shpreh falënderim i veçantë për Besart Bajramin, për kontributin dhe bashkëpunimin e tij në procesin e harmonizimit dhe verifikimit të emërtimeve të rrugëve.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit

01 Nr 400/01- 43180 dt. 12/10/2026

Në bazë të nenit 58 i Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit te Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 11, 12, 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës''), nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e ardhshme të aprovoi këtë:

P r o p o z i m V e n d i m
Për diskutim të Raportit të auditimit të pajtueshmërisë "Menaxhimi i pronave të dhëna me qira në Komunën e Gllogocit për periudhën 2024-2025

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës që për mbledhjen e Kuvendit të miratoj diskutimin publik të Raportit të auditimit të pajtueshmërisë "Menaxhimi i pronave të dhëna me qira në Komunën e Gllogocit për periudhën 2024-2025.

Neni 2

Në këtë diskutim do të debatohen të gjeturat dhe rekomandimet e Auditorit të përgjithshëm lidhur me menaxhimin e pronave të dhëna me qira në Komunën e Gllogocit për periudhën 2024-2025.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi janë përgjegjësc Kuvendi Komunal dhe Zyra e Kryetarit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Drenasit.

Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Komuna e Drenasit me datë 09.10.2026 nga Vlora Spanca, auditore e Përgjithshme e Republikës së Kosovës kemi pranuar Raportin e auditimit të pajtueshmërisë "Menaxhimi i pronave të dhëna me qira në Komunën e Gllogocit për periudhën 2024-2025, së bashku me të gjeturat dhe rekomandimet e tij, ku duke marrë parasysh këtë dhe nevojës së shqyrtimit të të njëjtit ,Kryetari i Komunës përmes këtij propozim vendimi i propozon Kuvendit të Komunës që duke marr parasysh legjislacionin në fuqi dhe nevojës për diskutimin dhe trajtimin me prioritet të raportit në fjalë që synon adresimin dhe zgjedhjen e problemeve të kësaj natyre në nivel lokal të votohet ky propozim vendim.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna Drenas (Gllogocit)
Kuvendi Komunal

01- Nr 400/01-43026 dt. 09/10/2026

Në veshtrim të nenit 58, nën-paragrafi h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 6 të Ligjit për familje të Kosovës me nr. 2004/32, nenit 52 pika 4 të Ligjit 08/L-255 Për Shërbime Sociale dhe Familjare, neni 3 pika 1.45 të Ligjit 06/L–084 Për Mrojtjen e Fëmijës, me propozim të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM
PËR THEMELIMIN E ORGANIT TË KUJDESTARISË

Neni 1
Themelimi

Me këtë propozim vendim, kërkohet të themelohet Organi i Kujdestarisë në kuadër të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Drenasit, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 2
Funksioni

Organi i Kujdestarisë është organ administrativ komunal kompetent për çështjet sociale dhe përbëhet nga ekspertë me përvojë profesionale në fushën e mbrojtjes sociale, psikologjisë, drejtësise, pedagogjisë, apo fushave të ngjashme me qëllim të ushtrimit të kompetencave në mbrojtjen dhe ndihmën familjare, në përputhje me Ligjin për Familjen të Republikës së Kosovës.

Neni 3
Përbërja

Organi i Kujdestarisë përbëhet nga profesionistë me përvojë dhe kompetencë profesionale në fushat përkatëse të mbrojtjes sociale dhe familjare, nga këta anëtarë;

1. Vlorjan Mcha - Kryesues;
2. Ariana Isufi - anëtare;
3. Shpetim Nika - anëtar;
4. Filloreta Hajdari - anëtare
5. Anduena Gllareva - anëtare
6. Teuta Morina- anëtare rezerve

- Në rast të mungesës apo konfliktit të interesit të ndonjë nga anëtarët e caktuar, anëtari rezervë i merr të gjitha kompetencat dhe përgjegjësit e anëtarit të rregullt.
- Në rast të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, transferimit, emërimit apo plotësimit të vendit të punës përmes procedurave të rekrutimit, zyrtari i ri i sistemuar në pozitën përkatëse zëvendëson zyrtarin e përcaktuar me këtë vendim dhe ushtron të njëjtat detyra dhe përgjegjësi, në pajtim me këtë vendim dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 4
Kompetencat

Organi i Kujdestarise ushtron detyrat dhe kompetencat e përcaktuara me Ligjin për Familje dhe legjislacionin përkatës në fuqi, përfshirë;

- Mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve;
- Kujdesin për personat pa përkujdesje prindërore;
- Mbikqyrjen e ushtrimit të kujdestarise;
- Dhënien e mendimeve profesionale për gjykatat dhe institucionet tjera kompetente,
- Ndërrmarrjen e masave të tjera të parapara me ligj.

Neni 5
Zbatimi

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Qendra për Punë Sociale dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Drenas.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky Propozim Vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës, dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja në Prishtinë.

KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci

Arsyetim

Me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të fëmijëve, personave pa përkujdesje prindërore dhe personave të tjerë që, kanë nevojë për mbrojtje dhe kujdes institucional, sipas nenit 6 të Ligjit për familje të Kosovës me nr. 2004/32, është e nevojshme themelimi dhe funksionalizimi i Organit të Kujdestarisë në kuadër të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Drenasit.

Sipas nenit 52 pika 4 e Ligjit Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, në kuadër të Qendrës për Punë Sociale themelohet Organi i Kujdestarisë, i cili funksion si grup i profesionistëve në përputhje me ligjin, i cili është përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, me qëllim që vendimmarrja dhe trajtimi i rasteve të bëhet mbi bazën e ekspertizës profesionale dhe në funksion të interesit më të mirë të fëmijës dhe mbrojtjes së personave që kanë nevojë për kujdestari.

Themelimi i këtij Organi synon të sigurojë një qasje profesionale, të koordinuar dhe të përgjegjshme në trajtimin e rasteve të kujdestarisë, duke mundësuar vlerësimin profesional të nevojave të personave në mbrojtje, mbikëqyrjen e ushtrimit të kujdestarisë, dhënien e mendimeve profesionale për gjykatat dhe institucionet tjera kompetente, si dhe ndërmarrjen e masave të parapara me legjislacionin në fuqi.

Duke marrë parasysh rëndësinë e mbrojtjes institucionale të këtyre kategorive dhe nevojën për funksionim të rregullt e profesional të shërbimeve të kujdestarisë në Komunën e Drenasit, si dhe bazen ligjore përkatësisht Ligjin Nr. 2004/32 për Familjen e Kosovës, dhe Ligjin Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, propozohet që Kuvendi i Komunës së Drenasit ta miratojë këtë Propozim-Vendim për Themelimin e Organit të Kujdestarisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Komuna/Opstina/Municipality Drenas (Gllogoc)
Zyra e Kryetarit
01 Nr. 400/01-43701 Dt. 15/10/2026

RAPORTI FINANCIAR JANAR - SHTATOR 2026

TETOR 2026

1. Hyrje

Raporti financiar buxhetor, për periudhën janar – shtator 2026, është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët: 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit, nr. 03/L – 048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.
Raporti i përgatitur nga Kryetari i Komunës, mbulon periudhë janar – shtator të vitit fiskal dhe paraqet informatën e përcaktuar, që ka të bëjë me arkëtimin, shpenzimet dhe të dhënat mbi investimet kapitale.

1.1. Performanca e të hyrave

Inkasimi i të hyrave vetanake ka vazhduar gjatë këtij tremujori të tretë ku të hyrat direkte kanë shënuar një trend pozitiv krahasuar me periudhen e njejtë të vitit 2025. Gjithsejt vlera e planifikuar e të hyrave gjatë kesaj periudhe ishte 2,269,199.00 € ndërsa shuma e realizuar e të hyrave direkte është 1,189,981.29 €, dhe të hyrave indirekte 822,957.00 €.

1.2. Performanca e shpenzimeve

Shpenzimet buxhetore për këtë periudhë kanë arritur vlerën prej 17,414,002.26 € përgjatë nëntëmujorit të vitit 2026, apo 70.14 % të buxhetit t ë alokuar të komunës për vitin 2026. Ky shpenzim kryesisht është i ndikuar nga ekzekutimi më i lartë i shpenzimeve nga kategoria e pagave dhe mëditje si dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të cilat derivojnë nga Kontrata Kolektive.

Shpenzimet për *paga dhe shtesa:* gjatë kësaj periudhe, shënuan vlerën prej 10,919,256.47 €, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 83.20 % krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori. Në këtë normë të ekzekutimit është përfshirë edhe ekzekutimi I pagës 13 për vitin 2025 e cila nuk ishte e planifikuar me buxhet fillestar. Poashtu vlera prej 10,696.22€ është ekzekutuar për vendime gjyqësore.

Shpenzimet në kategorinë ekonomike- *mallëra dhe shërbime:* gjatë kësaj periudhe vlera e këtyre shpenzimeve ka arritur shumën prej: 1,681,802,24. € apo 62.44 % të buxhetit të planifikuar për këtë kategori prej ku 460,886.55€ janë ekzekutuar për vendime gjyqësore.

Shpenzimet në kategorinë ekonomike- *Komunali,* kanë arrit shumën e ekzekutimit prej: 370,471.80 € apo 76.06 % të buxhetit të planifikuar, shuma prej 107,922.28€ është shpenzuar për vendime gjyqësore.

Shpenzimet për kategorinë ekonomike- *subvencione dhe transfere,* shënuan vlerën prej 527,600.47 € gjatë kësaj periudhe, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 69.85 % krahasuar me vlerën e përgjithshme të alokimit të buxhetit të kësaj kategorie për këtë periudhë.
Nga vlera e përgjithshme e ekzekutimit, 91,671.87€ janë ekzekutuar për vendime gjyqësore.

Shpenzimet kapitale arritën vlerën e realizimit prej: 3,914,871.28 €, që është 50.40 % e buxhetit të alokuar për vitin 2026 prej nga vlera prej 487,044.01€ është ekzekutuar për vendime gjyqësore.

Sa i përket **buxhetimit gjinor** mund të themi se përqindja e femrave në listën e të punësuarve arrin në 56.3 % dhe buxheti i pagave i shpenzuar për këtë kategori ka shkuar në këtë përqindje të shpenzimit. Gjithashtu në periudhën Janar- Shtator komuna ka ndarë dhe subvencione për lehona, bursa, shërbime të varrimit dhe transportit.

Të hyrat vetanake deri tremujorin e tretë të vitit 2026 dhe krahasimi me vitet paraprake

Përshkrimi	2024	2025	2026	% me 2025
			në Euro	
1.TOTALI I TË HYRAVE	1,632,834.28	1,472,223.85	1,189,981.29	80.83
1.1. Të hyrat nga kodi 16301	84,798.56	82,127.79	39,253.00	47.80
Te hyrat nga viti I kaluar	-	565.50	-	-
Te hyrat në pritje per shperndarje	26.00	-	-	-
Taksa për certifikata (50013-50016)	39,802.00	33,809.00	32,155.00	95.11
Taksa per verifikimin e dokumenteve te ndryshme 50017	3,880.18	910.68	593.50	-
Vert.Fotok.dokumentacionit 50018	700.5	409.99	442	107.81
Kerkesat 50019	4,198.50	4,617.00	5,062.50	109.65
Gjobat tjera 50107	165.33	100.00	-	-
Qiraja nga vendosja e objekteve tregtare 50407	35,622.00	40,790.00	1,000.00	-
Të Tjera 50413	-	-	-	-
Qeraja për Objektet Komunale 50408	-	925.62	-	-
Te hyra tjera 50424	404.05	-	-	-
1.2.Të hyrat nga kodi 16601	15,265.10	26,762.50	14,939.50	55.82
Të hyra nga Inspeksioni 50104	15,265.10	26,762.50	14,939.50	55.82
1.3.Të hyrat nga kodi 17501	433,937.87	525,181.24	538,416.15	102.520065
Tatimi në pronë 40110	326,890.87	406,841.24	409,166.15	100.57
Tax për regjistrimin e automjetit 50001	107,047.00	118,340.00	129,250.00	109.22
1.4. Të hyrat nga kodi 18001	2,461.00	1,078.00	1,435.50	133.16
Tax për parki.nga Sh.Publike 50008	1,995.00	1,078.00	1,315.50	122.03
Taksa per leje ndertimi 50009	466.00	-	120.00	-
Tax për treg të hapur-kafsheve 50406	-	-	-	-
1.5. Të hyrat nga kodi 18161	-	-	4,447.00	-
Taksa për leje ndertim 50009	-	-	4,297.00	-

Taksa të tjera admminstrative 50019	-	-	150.00	-
1.6. Të hyrat nga kodi 47001	-	-	292.00	-
Taksa të tjera administrative 50019	-	-	292.00	-
1.7.Te hyrat na kodi 48001	110,893.90	43,990.00	101,865.00	231.56
Taksa të tjera administrative 50019	-	-	520.00	-
Licenca per aktivitete individuale dhe profesionale 50201	110,893.90	43,990.00	101,345.00	230.38
1.8.Të hyrat nga kodi 65005	63,307.50	52,340.50	117,870.50	225.20
Tax regjistrim prone 50011	51,532.50	45,700.00	27,802.00	60.84
Tax fletposeduese kopje planit. 50032	10,681.00	6,432.50	12,208.00	189.79
Qiraja nga prona publike 50408	-	-	63,545.50	-
Matje gjeodezike 50504	1,094.00	208.00	14,185.00	6787.08
Taks për ndërrim të destinimt të pronës 50012	-	-	130.00	-
1.9.Të hyrat nga kodi 66310	449,679.38	380,279.06	303,908.08	79.9171219
Taksa per parkim publik, kamping dhe rekreacion 50008	60.50	576.00	2,160.17	375.03
Taks per leje ndertimi 50009	419,550.57	308,245.84	241,409.19	78.32
Shfrytzimi I pronës Komunale 50405		6,084.84	38,180.49	627.47
Tax per ndrrim te destinimit te tokës 50012	9,736.76	62,277.00	16,002.55	25.70
Tax për legalizim te objekteve 50026	5,188.34	3,094.38	6,004.02	194.03
Qiraja nga vendosja e objekteve tregtare 50407	24.00	-	-	-
Gjobat e tjera 50107	-	-	151.66	-
Shitja e pasurise publike 50413	15,119.21	1.00	-	-
2 .Të hyrat nga kodi 73010	34,478.00	36,287.00	4,280.56	11.80
Qiraja nga prona publike 50408	-	-	4,280.56	-
2.1.Të hyrat nga kodi 73100	-	-	26,293.00	-
Participimi shendetësi	34,478.00	36,287.00	26,293.00	72.46
2.2. Te hyrat nga kodi 85001	117.5	157	778.00	495.541401
Te hyrat nga qiraja e objekteve 50408	117.5	157	778.00	495.541401
2.3. Te hyrat nga kodi 92210	28,369.50	33,463.40	36,203.00	108.19
Participimi Arsimi	28,369.50	33,463.40	36,203.00	108.19
2.4. Të Hyrat Indirekte	409,525.97	813,588.50	822,957.00	101.151503
Gjobat e gjykatave	65,642.97	62,845.50	46,382.00	73.80

Gjobat e komunikacionit	343,883.00	750,743.00	776,575.00	103.44
2.5. Donacion	-	290,557.36	-	-

Shpenzimet për periudhën janar– shtator 2026 dhe krahasimi me vitet paraprake

Përshkrimi	2024	2025	2026	Buxheti për vitin 2026	% e shpenzimit
Vitet	1	2	3	4	Me vitin 2025
2. GJITHSEJ SHPENZIMI	15,448,125.75	17,604,288.02	17,414,002.26	24,826,746.59	98.92
Shpenzimet operative	10,652,903.29	10,937,644.17	12,971,530.51	16,304,140.42	118.60
2.1.1 Paga dhe shtesat	9,153,851.15	9,177,249.88	10,919,256.47	13,123,474.52	118.98
2.1.2. Mallra dhe shërbime	1,322,892.48	1,541,466.65	1,681,802.24	2,693,611.04	109.10
2.1.3 Shpenzime komunale	176,159.66	218,927.64	370,471.80	487,054.86	169.22
2.2 Subvencione dhe transfere	328,317.54	375,389.72	527,600.47	755,299.05	140.55
2.3 Shpenzime kapitale	4,466,904.92	6,291,254.13	3,914,871.28	7,767,307.12	62.23

Subvencionet Janar- Shtator 2026 dhe krahasimi me vitet parapake

Përshkrimi	2024	2025	2026	% me
	Shumat në Euro			2025
Zyra e kryetarit	4,000.00	12,000.00	5,000.00	41.67
DSHPE	55,575.00	59,960.00	81,000.00	135.09
D.Bujqësis	33,000.00	55,000.00	82,500.00	150.00
D.Zhvill ekonomik	18,499.62	19,302.99	46,756.42	242.22
D.Kultures	104,777.00	135,000.00	130,000.00	96.30
Drejtoria e Shëndetësisë	60,758.00	93,626.73	92,918.00	99.24
Drejtoria e Arsimit	52,007.92	500.00	89,426.05	17885.21
Gjithsej	241,109.50	375,389.72	527,600.47	140.55

Subvencionet Janar- Shtator 2026 dhe krahasimi me vitet parapake

Përshkrimi	2024	2025	2026	% me 2025
	Shumat në Euro			
Zyra e kryetarit	4,000.00	12,000.00	5,000.00	41.67
DSHPE	55,575.00	59,960.00	81,000.00	135.09
D.Bujqësis	33,000.00	55,000.00	82,500.00	150.00
D.Zhvill ekonomik	18,499.62	19,302.99	46,756.42	242.22
D.Kultures	104,777.00	135,000.00	130,000.00	96.30
Drejtoria e Shëndetësisë	60,758.00	93,626.73	92,918.00	99.24
Drejtoria e Arsimit	52,007.92	500.00	89,426.05	17885.21
Gjithsej	241,109.50	375,389.72	527,600.47	140.55

Shpenzimet në projekte kapitale për periudhën janar–qershor 2026

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-3/2026	Mbetja	Progresi i TM-3/2026 në %
	1	2	3	4=2-3	5=3/2
16301	Administrata dhe personeli				
47919	Veture Zyrtare	100,000.00	8,140.00	91,860.00	8.14
	Totali	100,000.00	8,140.00	91,860.00	8.14

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-2/2026	Mbetja	Progresi i TM-2/2026 në %
	1	2	3	4=2-3	5=3/2
18001	DSHPE				
53330	Rreg.dhe rrethimi I varrezave Drenas dhe Komoran	20,000.00	-	20,000.00	-
53341	Zgjerimi i kamerave Drenas dhe Komoran	10,000.00	9,772.76	227.24	97.73
53364	Rregullimi dhe zgjerimi I vendndaljev dhe mbulimi I tyre	5,000.00	4,732.18	267.82	94.64
	Totali	35,000.00	14,504.94	20,495.06	41.44

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-3/2026	Mbetja	Progresi i

					TM-3/2026 në %
	1	2	3	4=2-3	5=3/2
18161	**Drejtoria e Infrastruktures Publike**				
48254	Rregullimi I shtratit të lumit Drenica dhe Verbica	35,000.00	11,000.00	24,000.00	31.43
48632	Asfaltimi I rrugës Gllanasellë, Godanc	20,000.00	20,000.00	0.00	100.00
48635	Asfaltimi I rrugës Paklek I vjeter, I Ri, Vasilevë	80,000.00		80,000.00	-
48638	Asfakltimi I rrugës Dobroshec, Çikatovë e vjeter	120,000.00		120,000.00	-
48643	Asfaltimi i rruges ne fshatrat Gradicë dhe Likoshan	50,000.00	50,000.00	0.00	100.00
48646	Asfaltimi rruges Arllat Negroc Gjergjic Bytyq	93,000.00	23,267.50	69,732.50	25.02
48648	Asfaltimi I rruges Sankoc Fushticë	50,000.00		50,000.00	-
48653	Asfaltimi I rruges Shtuticë,Verboc,Polluzhë	100,000.00	1,500.00	98,500.00	1.50
48656	Asfaltimi I rruges Llapushnik,Poterk Vukoc	50,000.00		50,000.00	-
48658	Asfaltimi I rruges Z.ulët,Lartë K. e ulet dhe e lartë	57,052.71		57,052.71	-
48661	Ndertimi I kapaciteteve të ujësjellësit Drenas	600,000.00	521,737.99	78,262.01	86.96
48682	Bashkfinancim projektesh me donator te jashtem	25,000.00		25,000.00	-
49297	Zgjerimi dhe ndertimi I sheshit Fehmi e Xheve Lladrovci Dr.	1,053,407.79	536,737.26	516,670.53	50.95
49299	Asfaltimi I rruges Llapushnik Berish	2,000.00		2,000.00	-
51324	Asfaltimi I rrugve Tersteniku I,II dhe Gllobar	100,000.00	50,000.00	50,000.00	50.00
51340	Asfaltimi I rruges Baicë Krajkovë Damanek Shtrubullovë	59,990.30		59,990.30	-
52309	Ndërtimi I Rrugës Bregut te Çiqavicës	2,000.00		2,000.00	-
52310	Ndërtimi I parkut dhe shtigjet për Këmbësor	0.00		0.00	
53631	Ndërtimi I Kolektorve për grumbullimin e ujërave te zeza	120,446.00	11,179.70	109,266.30	9.28
53635	Rregullimi I Trotuarve dhe ndriqimit Publik	720,000.00	391,192.60	328,807.40	54.33
53645	Asfaltimi I rrugëve dhe Kubzimi Drenas I,II,III,IV	320,000.00	128,095.78	191,904.22	40.03
53652	Asfaltimi I rrugëve Komorani I,II,III,IV	20,000.00		20,000.00	-

53659	Ndërtimi I Tombinave dhe mureve mbrojtëse	50,000.00	25,468.09	24,531.91	50.94
53660	Ndërtimi zgjerimi dhe rikonstruimi I rrugëve të asfaltuara	430,409.91	425,409.91	5,000.00	98.84
53666	Ndertimi, zgjerimi i rrjetit të kanalizimit	250,000.00	149,999.99	100,000.01	60.00
53670	Asfaltimi I rrugëve Abri dhe Tërdec	20,000.00	-	20,000.00	-
53672	Asfaltimi i rrugëve Nekoc Kizhnarekë	65,474.72	-	65,474.72	-
53674	Hapja e kanaleve Kullucse gjatë rrugëve Drenas Komoran	0.00	-	0.00	-
54100	Ndertimi I rrugëve fushore ne Komunën e Drenasit	269,965.00	261,689.63	8,275.37	96.93
54104	Ndertimi I rruges tranzit Drenas-Kroi I Mbretit	0.00	-	0.00	-
54108	Ndertimi I digës për ujëmbledhës në fshatin Verboc	0.00	-	0.00	-
54266	Rregullimi I inf.ne parkun c pishave ne Komoran- Fushticë	0.00	-	0.00	-
55568	Rehabilitimi I rruges dhe ndertimi I trotuarit Arllat-Negrovc dhe Vuçak	402,000.00	187,509.76	214,490.24	46.64
92236	Ndertimi I kapaciteteve të ujësjellësit Drenas	38,583.06	31,485.35	7,097.71	81.60
40	Ekzekutimi I Vendimeve Gjyqesore	489,006.21	487,044.01	1,962.20	99.60
	Totali	**5,693,335.70**	**3,313,317.57**	**2,380,018.13**	**58.20**

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-3/2026	Mbetja	Progresi i TM-3/2026 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
47001	**Bujqësia**				
	Grant I donatorve te brendshem	2,213.32	-	2,213.32	-
	Totali	**2,213.25**	-	**2,213.32**	-

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-3/2026	Mbetja	Progresi i TM-3/2026 në %
	1	2	3	4=2-3	5=3/2
73100	**Sherbimet e shendetesis primare**				
49181	Paisje speciale mjeksore mbi 1000	91,402.97	91,402.97	-	-
55574	Ndertimi I QMF-se Arllat	100,000.00	-	100,000.00	-

55575	Rregullimi I oborreve dhe rrethojave te QKMF.QMF dhe AMF Arllat Sankoc Abri,Dobroshec dhe Vasileve	10,000.00	-	10,000.00	-
	Totali	**201,402.97**	**91,402.97**	**110,000.00**	**45.38**

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-3/2026	Mbetja	Progresi i TM-3/2026 në %
	1	2	3	4=2-3	5=3/2
75502	**Sherbimet Rezidenciale**				
54131	Ndertimi I shtepise per komunitete - sherbime komuale per persona me aftesi te kufizuara	230,000.00	-	230,000.00	-
	Totali	**230,000.00**	-	**230,000.00**	-

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-3/2026	Mbetja	Progresi i TM-3/2026 në %
	1	2	3	4=2-3	5=3/2
85001	**Drejtoria e Kulturës 85001**				-
89114	Ndertimi I stadionit faza e dyte	340,000.00	207,990.00	132,010.00	61.17
20712	Ndërtimi I fushave sportive Komoran,Korroticë e Eperme dhe Arllat	122,000.00		122,000.00	-
	Totali	**462,000.00**	**207,990.00**	**254,010.00**	**45.02**

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-3/2026	Mbetja	Progresi i TM-3/2026 në %
	1	2	3	4=2-3	5=3/2
93000	**Arsimi Fillor**				
51325	Dixhitalizimi I institucioneve arsimore ne Drenas	120,437.20	-	120,437.20	-
54209	Instalimi I nxemjeve qendrore-riparimi I kulmit ne SHFMU"Xheladin Gashi -plaku" Komoran	110,918.00	-	110,918.00	-
54212	Ndertimi I SHFMU "Rasim Kiqina" Drenas paralele e ndare ne Shtrubullovë	300,000.00	164,960.80	135,039.20	54.99

55604	Ndertimi I aneksit te shkolles "Arif Shala" dhe "Naim Frasheri"	175,000.00	114,555.00	60,445.00	65.46
20703	Ndertimi I parkingjev ne shkolla "G.Elshani, A.Shala, A.Bejta, Xh.Gashi, B.Curri, D.Drenices, L.Gurakuqi, Rilindja, A.Bujupi, 24 Korriku	40,000.00	-	40,000.00	-
20704	Ndertimi I rrethojave te fushave te jashtme sportive ne Sh.Galica, A.Bejta, G.Sylaj dhe D.Forteses	35,000.00	-	35,000.00	-
20705	Ndertimi I rrethojave te oborreve te shkollave H.Prishtina, F.Grajqevci. dhe M.Gradica	40,000.00	-	40,000.00	-
20707	Ndetimi I pjerrinave ne hyrje te objekteve shkollore per PAK,Shtuticë,Dobroshec,Gllanasell dhe Gllobar	10,000.00	-	10,000.00	-
20708	Trafo per furnizim te objektit te qerdhes " Ardhmeria"	32,000.00	-	32,000.00	-
20709	Instalimi I nxemjeve qendrore me pelet ne Gj.Kastrioti Skenderbeu, R.Kiqina, A.Gashi, Z.Hajdini, F.Lladrovci	50,000.00	-	50,000.00	-
20710	Furnizimi I Shkollave me tabela te menqura dhe paisje perçjellese	110,000.00	-	110,000.00	-
20711	Ndertimi I shkalleve emergjente ne shkollat fillore ne Komunen e Drenasit, B.Curri,R.Kiqina, Z.Hajdini , Migjeni, Gj.K.Skenderbeu, a.Bujupi, H.Bajraktari	20,000.00	-	20,000.00	-
	Totali	**1,043,355.20**	**279,515.80**	**763,839.40**	**26.79**
611	**Totali KOMUNA**	**7,767,307.12**	**3,914,871.28**	**3,852,435.84**	**50.40**

Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Municipality Drenas
Kuvendi i Komunës

02 **Nr.** 07/01-4389 **dt.** 16/10/ **2026**

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d), neni 17 pika i) dhe nenit 40 pika l) të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28, datë: 04. Qershor 2008, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit. Kuvendi i Komunës së Drenasit në propozim të kryetarit të komunës, në mbledhjen e rregullt me datë: _____/2026 të aprovoj këtë:

DEKLARATË MBËSHTETËSE

I. Kuvendi i Komunës së Drenasit shpreh mbështetjen e plotë për Deklaratën mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike, e cila është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 nëntor 2024 dhe e nënshkruar nga 66 deputetë të Legjislaturës së VIII.

II. Kuvendi i Komunës së Drenasit mbështet gjithashtu Komunikatën Mbështetëse të datës 14 korrik 2025, të nënshkruar nga anëtarë të kuvendeve komunale në nivel rajonal, përfaqësues të shoqërisë civile dhe institucioneve të tjera publike, në kuadër të takimit të organizuar nga Misioni i OSBE-së, të mbajtur në Gjilan.

III. Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës angazhohet për forcimin e bashkëpunimit institucional dhe shoqëror me qëllim parandalimin dhe eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike.

IV. Kuvendi i Komunës obligon strukturat përkatëse komunale, përfshirë Kryesuesin e Kuvendit Komunal, Kryetarin e Komunës dhe Zyrën për Barazi Gjinore, që të promovojnë Deklaratën dhe parimet e saj përmes aktiviteteve informuese, komunikimit publik dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe partnerët relevant.

V. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së .

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Burim Bujupi